



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Teknikë Laboratori Mjekësor”
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë
Universiteti “Aldent”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Vjollca Durro

2. Prof. Asoc. Nevila Heta

Nëntor 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e studimit Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor”
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aldent”


Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aldent”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH nr. 339, datë 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/ VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	15 PAE/ 9 PAK
18	Numri i studentëve (2 vitet e fundit):	37 studentë
19	Komente/ të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Aldent (UA) është një institucion jopublik i arsimit të lartë i licencuar me VKM Nr. 673, datë 27.09.2006. UA është riakredituar me VBA Nr. 1, datë 27.01.2023. Universiteti Aldent përbëhet nga tre fakultete me profil mjekësor: Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakulteti i Shkencave Dentare. FSHMT përbëhet nga tre njësi bazë si: Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri dhe Qendra e Promovimit të Shëndetit dhe në total ofron 7 programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, përkatësisht 4 programe të ciklit të parë dhe 3 programe të ciklit të dytë Master i Shkencave. Programi i studimit “Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor” është hapur me Urdhër të MASH nr. 339, datë 17.09.2021 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Teknikë Laboratori Mjekësor” në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, në Universitetin “Aldent”. Programi i studimit “Master i Shkencave në “Teknik Laboratori Mjekësor” zhvillohet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin “Aldent” , pranë departamentit Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri.

Ky program është organizuar dhe strukturuar në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit, ligjin 80/2015 për “Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve ligjore në fuqi për IAL dhe i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), i organizuar me 120 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje 2 vite akademike.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit Master i Shkencave në "Teknikë Laboratori Mjekësor", i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin ALDENT (UAL). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve për programin e studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive.

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet njerëzore financiare infrastruktura logjistika për realizimin e programit të studimit; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks [aneks, lista e evidencave].

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Vjollca Durro dhe Dr. Nevila Heta. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Ersi Dako.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë

hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.

- Vizita në UAL e zhvilluar në datat 23-24 Maj 2023. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UA.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Më datë 18.10.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 122/20 Prot., datë 18.10.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL, përmes AMS, më datë 23.10.2023, me shkresë zyrtare Nr. 18/5 Prot., datë 23.10.2023, ka dërguar komente mbi draft raportin. GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si në vijim:

1. **Komenti i IAL (konkluzionet në fq. 17):** Në lidhje me komentin sqarojmë se kurrikula aktuale e programit të studimit “Master i Shkencave” në Teknikë Laboratori Mjekësor aplikohet për herë të parë e tillë. Hartimi i kurrikulës është konform udhëzimeve dhe rekomandimeve edhe të Direktivës Europiane, e cila thekson se orët e praktikës profesionale duhet të zënë pothuajse gjysmën e orëve të kurrulës. Prandaj disiplinat A dhe B zënë një pjesë lehtësisht më të madhe të përqindjes së orëve, gjithsesi brenda limiteve të VKM 41/2018.

Komenti i GVJ: Referuar komentit të parë të IAL lidhur me konkluzionet në fq. 17 (që i përket standardit II.1, kriteri 1), GVJ i qëndron komentit dhe rekomandimit të dhënë. Numri total i ECTS për kategoritë e lëndëve A+B, bazuar në VKM 41/2018, i ndryshuar, duhet të jetë jo më pak se 60% dhe në këtë program studimi për kategorinë e lëndëve A+B përbën 64.17%. Sikurse evidentuar edhe në raport, % e parashikuar për kategoritë C dhe D nuk është në përputhje me parashikimet e VKM 41/2018, i ndryshuar, ku përkatësisht kategoria C ka 9.17% nga 12-20% që kërkohet të jetë sipas VKM, dhe kategoria D ka 11.67% nga 10% që kërkohet sipas VKM.

2. **Komenti i IAL (konkluzionet në fq. 46):** Në lidhje me komentin sqarojmë se personeli Msc është i angazhuar në pozicionin *Asistent Lektor*, konform Ligjit të arsimit

të lartë 80/2015, dhe roli i tyre në mësimdhënie është asistent lektor, siç citohet edhe në kontratat individuale të stafit akademik të kësaj kategorie. Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që Universiteti Aldent ka me shumë Universitete Ndërkombëtare, që ofrojnë programe studimi në fushën e Shkencave Mjekësore Teknike si edhe në kuadër të kritereve të njohjes së diplomave ndërkombëtarisht, ne kemi vlerësuar specifikat e praktikave që realizohen në këtë program studimi, ashtu siç janë specifike të gjitha profilet e Shkencave Mjekësore Teknike, duke angazhuar staf i cili ka formimin specifik të fushës edhe pse janë me Msc. Këto konstatime stafi jonë akademik i ka përfituar gjatë eksperiencave në kuadër të periudhave të shkëmbimit akademik, si duke vizituar apo pritur në Institucionin tonë, si edhe bisedimeve me kolegë ndërkombëtarë.

Komenti i GVJ: Referuar komentit të IAL (që i përket standardit IV.1, kriteri 1) GVJ i qëndron komentit dhe rekomandimit të bërë. Angazhimi në mësimdhënie i personelit akademik me Msc. nuk është në përputhje me nenin 59, pika 6 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, ku citohet: *“Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”*.

- 3. Komenti i IAL (konkluzionet në fq. 76):** Në lidhje me komentin sqarojmë se aplikimi dhe analizimi i të dhënave të marra nga pyetësorët e studentëve dhe të stafit realizohet në bashkëpunim me Institutin për Cilësi në Arsimin e Lartë, i cili përdor metodat analitike dhe digjitale më bashkëkohore. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë pasi njihet me rezultatet, harton një përmbledhje me gjetjet dhe me plan masat e rekomanduara për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët, të cilën ia paraqet Senatit Akademik.

Komenti i GVJ: Referuar komentit të IAL (që i përket standardit VI.3, kriteri 3) GVJ i merr në konsideratë komentet e bëra nga IAL dhe ndryshimi është pasqyruar në raport.

- 4. Komenti i IAL (konkluzionet në fq. 80):** Në lidhje me komentin sqarojmë se Universiteti Aldent ka tashmë një *historik Institucional* të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë e zhvillon aktivitetin e saj që nga viti 2006 e në vijim, duke ndjekur udhëzimet dhe përditësimet e marra nga i gjithë kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke respektuar një rregullore të funksionimit, e bazuar në kompetencat statuore, duke hartuar plan vjetor të punës, duke bashkëpunuar me të gjitha stukturat akademike dhe administrative të Universitetit dhe duke monitoruar dhe rekomanduar gjithmonë me qëllim rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në nivel institucional.

Komenti i GVJ: Referuar komentit të IAL (që i përket standardit VI.5, kriteri 5), GVJ i qëndron komentit dhe rekomandimit të dhënë.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti Aldent (UA) është një institucion jo publik i arsimit të lartë i licencuar me VKM Nr. 673, datë 27.09.2006 dhe i riakredituar me VBA Nr. 1, datë 27.01.2023.</p> <p>Në përbërje të tij janë tre fakultete që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat mjekësore. Programet që ofron institucioni janë në përputhje me interesat dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të vendit në përputhje me profilin e institucionit. Programet e studimit të ofruara nga institucioni kanë si qëllim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare dhe janë në përputhje të plotë me misionin e UA, objektivat dhe fushën e veprimtarisë së Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike.</p> <p>Evidenca 4. Statusi i UA dhe Evidenca 6.1 Rregullorja FSHMT.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi MSH “Teknikë Laboratori Mjekësor” zhvillohet në Departamentin Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri (TLMI), të FSHMT. Referuar dokumentacionit mbështetës dhe RVB, GVJ konstaton se programi MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor” (TLM) është hartuar konform misionit dhe qëllimeve të UA dhe fushës së veprimtarisë së FSHMT sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore të IAL.</p> <p>Evidenca 6.1. Rregullorja FSHMT, Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit MSH në “Teknik Laboratori Mjekësor”.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor” është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UAL, Rregulloren e Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p> <p>Evidenca 4. Statusi i UA; Evidenca 6.1 Rregullorja FSHMT; Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”.</p>




<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor” është hartuar bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar, Strategjinë e zhvillimit institucional të UA, Strategjinë kombëtare të punësimit dhe arsim, Strategjia kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe informacionin si dhe objektivat dhe fushën e veprimtarisë së Fakultetit të Shkencave mjekësore Teknike</p> <p>Evidenca 4. Statusi i UAL dhe Evidenca 6.1. Regullorja FSHMT.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UA përbëhet nga tre fakultete që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat mjekësore. Programi MSH “Teknikë Laboratori Mjekësor” zhvillohet në Departamentin Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri pranë FSHMT. Programi MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor” është hartuar konform misionit dhe qëllimeve të UAL, fushës akademike dhe veprimtarisë së FSHMT si dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. Ky program bazohet dhe funksionon sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore të IAL.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti “Aldent” (UAL) ka një eksperiencë të gjatë në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë.</p> <p>Në përbërje të tij janë tre fakultete që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat mjekësore. Kjo tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon dhe burime njerëzore në staf akademik dhe mbështetës. Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor” është hapur me Urdhër të MASH nr. 339, datë 17.09.2021. Ky program realizohet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, në Departamentin Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri. Krahasuar me numrin aktual të studentëve të regjistruar dhe që ndjekin studimet, institucioni ka kapacitetet, burimet</p>




	<p>financiare dhe logjistike që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit. <i>GVJ e konsideron pikë të fortë infrastrukturën që disponon institucioni për realizimin e praktikës mësimore, ku janë në dispozicion 3 laboratorë mjekësorë, një laborator mikrobiologjik dhe dy laboratorë biokimik klinik ku kryhen procedurat laboratorike që nga marja dhe përpunimi i mostrës klinike, realizimi i procedurave të ndryshme, testimi, interpretimi i rezultateve të testimit. Laboratorët mjekësor ndihmojnë në praktikimin e aftësive dhe njohurive të marra nga studentët.</i></p> <p>Për realizimin e praktikës profesionale të studentëve FSHMT dhe UAL kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike dhe jo publike si Instituti i Shëndetit Publik, Qendra Kombëtare e transfuzionit të Gjakut, Laboratori mjekësor Genius, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, Spitali Universitar i Traumës.</p> <p>Evidenca 4 Statusi i UA dhe Evidenca 6.1 Regullorja FSHMT, evidenca Rregullorja e programit të studimit MSH në “Teknik Laboratori Mjekësor” Evidenca 25 Marreveshjeve bashkëpunimit, Evidenca 7. Tabela përmbledhëse, Evidenca 1. Urdhër për hapjen e programit të studimit. Vizita e ambienteve.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>FSHMT përbëhet nga tre departamente: Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri dhe Qendra e Promovimit të Shëndetit. FSHMT në total ofron 7 programe të ciklit të parë dhe të dytë:</p> <p>I. Programe në ciklin e parë Bachelor (katër programe):</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Bachelor në “Teknik Laboratori Mjekësor” b) Bachelor në “Infermieri të përgjithshme” c) Bachelor “Fizioterapi” d) Bachelor “Teknik imazherie dhe radioterapi” <p>II. Programe në ciklin Master i Shkencave (tre programe):</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Master i Shkencave në “Teknik Laboratori Mjekësor” b) Master i Shkencave në “Infermieri klinike” c) Master i Shkencave në “Fizioterapi klinike” <p>Profili i programeve dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tyre përputhet me atë të njësisë kryesore.</p>




	Evidenca 6.2 Rregullorja e studimit në FSHMT, Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor” realizohet në Departamentin Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri të FSHMT, fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me atë të programit të studimit. Programi i studimit është ndërtuar mbi bazën e Sistemit European të transferimit të krediteve ETC në përputhje të plotë me statusin e Universitetit dhe legjislacionin shqiptarë në fuqi. Programi i studimit zhvillohet në gjuhën shqipe dhe përfshin aktivitete mësimore në fushën e menaxhimit dhe organizimit të laboratorëve mjekësore, diagnozë molekulare, metodat e egzaminimeve në laborator, metodat e kërkimit shkencor dhe statistikë, të cilat përputhen me interesat dhe nevojat kombëtare. Evidenca 6.2 Rregullorja e studimit në FSHMT, Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”; Evidenca 11 sylabuset.
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Nuk i përket këtij programi
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nuk i përket këtij programi
Konkluzione	<i>UAL ka një eksperiencë të gjatë në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon dhe burimeve njerëzore në staf akademik dhe mbështetës. FSHMT përbëhet nga tre departamente dhe ofron 7 programe të ciklit të parë dhe të dytë. Programi MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor” realizohet në Departamentin Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri të FSHMT, fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me atë të programit të studimit.</i>

	<p><i>Për realizimin e praktikës profesionale të studentëve FSHMT dhe UAL kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike dhe jo publike.</i></p> <p><i>GVJ e konsideron pikë të fortë infrastrukturën që disponon institucioni për realizimin e praktikës mësimore, ku janë në dispozicion 3 laboratorë mjekësorë, një laborator mikrobiologjik dhe dy laboratorë biokimik klinik ku kryhen procedurat laboratorike.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>FSHMT ofron 7 programe studimi ku përfshihet dhe programi i studimit MSH në Teknikë Laboratori Mjekësor. Në këtë program studimi në të dy vitet akademike janë 37 studentë, ku shumica janë studentë të cilët kanë përfunduar programin Bachelor në UA. Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon.</p> <p>Sikundër u theksua gjatë takimit me drejtues të fakultetit dhe departamentit në realizimin e programit të studimit një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi i ngushtë që ekziston midis departamenteve të FSHMT dhe stafit akademik. Bashkëpunimi dhe detyrat brenda njësisë bazë apo programeve bazohen në rregulloren e funksionimit të FSHMT dhe Departamentit Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri (TLMI) ku realizohet programi i studimit.</p> <p>Për realizimin e procedurave të ndryshme vlerësuese, projekteve, hartimin e buxhetit, rekrutim stafi akademik etj. funksionojnë ngritja e grupeve “ad hoc” në përbërje të të cilit janë anëtarë të stafit akademik të departamentit të lëndëve paraklinike ose të departamenteve të tjera të FSHMT. Në fillim të çdo viti akademik, departamenti në bashkëpunim me dekanatin koordinon orarin mësimor dhe ngarkesën mësimore të stafit akademik midis njësive bazë të FSHMT si dhe të institucioneve shëndetësore ku realizohet praktika profesionale në funksion të realizimit të programit mësimor në këtë program studimi.</p>

	<p>Evidenca 6.2 Rregullorja e studimit në FSHMT, Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”, Evidenca 7 Tabela përmbledhëse.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit MSH “Teknikë Laboratori Mjekësor” institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione arsimore dhe shëndetësore brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Për realizimin e praktikës profesionale të studentëve FSHMT dhe UAL kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike dhe jo publike si Instituti i Shëndetit Publik, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Laboratori mjekësor Genius, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, Spitali Universitar i Traumës që ndihmojnë studentët të zhvillojnë praktikën profesionale, realizimin e temave të diplomës apo kërkimit shkencor si dhe krijimin e kontakteve për punësimin në vazhdimësi pasi disa prej bashkëpunëtorëve janë punëdhënës të drejtpërdrejtë.</p> <p>UA dhe FSHMT kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me IAL në kuadër të programit ERASMUS+ programin Ceepus si Universiteti Nikolla Koprtniku Poloni, Universiteti shkencave Mjekësore Kaunas Lituani, universitetin Ankaras Turqi etj. dhe projekte bashkëpunimi për mobilitetin e pedagogëve dhe studentë në kuadër të programit ERASMUS, si dhe një sërë projektsh ndërkombëtare në funksion të edukimit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Evidenca 10 Të dhëna për mobilitetin e stafit dhe studentëve. Evidenca 25 Marreveshjeve bashkëpunimit, takimi me stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Për realizimin e këtij programi studimi, FSHMT dhe departamenti ku realizohet ky program studimi, në fillim të vitit akademik caktojnë koordinatorët e praktikës dhe institucionit ku realizohet praktika profesionale apo aktivitete të tjera për mbikëqyrjen dhe koordinimin e realizimit të praktikës profesionale apo temave të diplomës.</p> <p>Evidenca 25 Marreveshjeve bashkëpunimit, Evidenca 6.5. Rregullore e praktikës profesionale.</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin</p>	<p>Departamenti TLMI si njësia bazë ku realizohet ky program studimi, në bashkëpunim me zyrën e marrëdhënieve me jashtë dhe NJBC në</p>

e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	mënyrë periodike analizon përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor” si mobilitetin e studentëve dhe stafin akademik, ecuria e zhvillimit të praktikës profesionale, realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me institucionet arsimore dhe shëndetësore, realizimin e projekteve të ndryshme. Të dhënat analizohen dhe pasqyrohen në raportin e NJSBC. Takimi me stafin akademik, Evidenca 10 Të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik. Evidenca 21.1.1 Raporti i NJSBC.			
Konkluzione	<i>Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon. Në realizimin e programit të studimit një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi ngushtë që ekziston midis departamenteve të FSHMT dhe stafit akademik, marrëveshjet e bashkëpunimit të UAL dhe FSHMT me institucionet arsimore dhe shëndetësore brenda dhe jashtë vendit. FSHMT dhe Departamenti TLMI si njësi bazë ku realizohet ky program studimi, në mënyrë periodike me NJSBC analizon përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË


Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese,	Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor” është hapur me urdhër Nr. 339, datë 17.09.2021 të MASH “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i

<p>të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Shkencave” në “Teknikë Laboratori Mjekësor” në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, në Universitetin “Aldent”. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri, pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Programi është i organizuar me 120 kredite (ECTS), kohëzgjatje 2 vite akademike, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor”. Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> A. Lëndë bazë 12 ECTS ose 10% (5-10%); B. Lëndë karakterizuese 65 ECTS ose 54.17% (50-60%); C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese 11 ECTS ose 9.17% (12-20%); D. Lëndë plotësuese 14 ECTS ose 11.67% (10%); E. Detyrime përmblylëse dhe diploma 18 ECTS ose 15% (10-15%). <p>GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në veprimtari formuese sipas kategorive A, B, C, D, E në ECTS/përqindje referuar VKM nr. 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, e ndryshuar për kategoritë C dhe D nuk përputhet me VKM. <i>Për sa më lart, GVJ rekomandon që të rishikohet shpërndarja e ECTS-ve të lëndëve në kategori duke respektuar peshën e tyre sipas VKM Nr. 41/2018, e ndryshuar.</i></p> <p>Bazuar në VKM-në 41/2018, përqindja e lëndëve të kategorisë A+B nuk duhet të jetë më pak se 60%. Në këtë program studimi këto dy kategori përbëjnë 64.17%.</p> <p>Evidenca 7. Tabelat përmbledhëse, tabela 9 dhe 10.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor” përmban një informacion të plotë në fushën e “Teknikë Laboratori Mjekësor” dhe sidomos në shërbime më specifike si metodat e ekzaminimeve laboratorike në mikrobiologji, biokimi</p>




<p>studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>klinike, histologji, ekzaminime laboratorike në obsetrikë, geriatri, metodat e diagnozës molekulare, imunologji etj. Njohuritë e fituara në këtë program studimi i krijojnë mundësi studentit që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës dhe zgjerimin e njohurive të tyre profesionale që i shërbejnë si bazë për kualifikime të mëtejshme. Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucioni. Në kurrikulën e tij përfshihen lëndë specifike për profilet të veçanta të “Teknikë Laboratori Mjekësor” që lidhen me nevojat e tregu të punës, lëndë specifike që lidhen me kërkimin shkencor, organizimin e strukturave shëndetësore. Gjithashtu njohuritë e fituara në këtë program studimi shërbejnë si bazë për vazhdimin e studimeve të mëtejshme të doktoratës apo trajnimeve të tjera.</p> <p>Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”. Evidenca 7. Tabela përmbledhëse.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor” është i organizuar me kohë të plotë në dy vite akademike të ndarë në katër semestra në total 120 ECTS nga të cilat 12 ECTS (300 orë mësimore) i përkasin praktikës profesionale e cila kryhet në vitin e dytë, 18 ECTS detyrimeve përmblylëse me punim të diplomës (450 orë prej të cilave 50 orë në auditor dhe 400 orë pune të pavarur). Praktika profesionale realizohet në institucionet shëndetësore me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi dhe mbikëqyrës nga një pedagog dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika. Vlerësimi bëhet nga pedagogu mbikëqyrës dhe institucioni ku realizohet praktika. Programi ka një rregullore të shkruar mbi organizimin e praktikës profesionale dhe vlerësimin e studentëve për praktikën. Në fund të praktikës studentët vlerësohen me provim përkatës.</p> <p>Evidenca 7. Tabela përmbledhëse; Evidenca 6.5. Rregullore e praktikës profesionale.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit</p>	<p>Nuk i përket këtij program studimi</p>

të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk i përket këtij program studimi
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Programi i studimit Msc në “Teknikë Laboratori Mjekësor” organizohet dhe financohet bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikë ne Shqipërisë” dhe aktet në nënligjore të këtij ligji. Kriteret për pranimin e studentëve në programin e studimit si dhe kuotat e pranimit miratohen me vendim të senatit akademik të universitetit. Takimi me stafin drejtues Dekani i FSHMT dhe Përgjegjësi i Departamentit; Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”; Evidenca 7. Tabela përmbledhëse.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Msc në “Teknikë Laboratori Mjekësor” realizohet në DTLMI të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, në përputhje me misionin dhe objektivat e këtij institucioni. Programi është i ngjashëm me programet Master i Shkencave në Teknikë Laboratori Mjekësor në universitete të tjera si dhe programin Mësimor në universitet e rajonit. Kjo u theksua edhe gjatë takimit me stafin drejtues të FSHMT. Takimi me stafin drejtues Dekani i FSHMT dhe Përgjegjësi i Departamentit; Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”; Evidenca 7. Tabela përmbledhëse.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor”, i ofruar nga FSHMT ka kodin përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimi të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Lëndët dhe modulet që realizohen në këtë program studimi janë të pajisur me një kod unik i cili përputhet me kodin që ka në syllabus dhe programin mësimor.

	Evidenca 7. Tabela përmbledhëse, tabela 10.			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet për këtë program studimi.			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), me kohëzgjatje 2 vite akademike, të ndara në katër semestra në total 120 ECTS nga të cilat 12 ECTS i përkasin praktikës profesionale e cila kryhet në vitin e dytë dhe 18 ECTS detyrimeve përmblylëse si punimit të diplomës dhe provimit përfundimtar. Programi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi dhe në përfundim të studimeve lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në "Teknikë Laboratori Mjekësor".</i></p> <p><i>Programi i studimit Master Shkencor në "Teknikë Laboratori Mjekësor" përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr. 41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar. Ndarja e lëndëve sipas kategorive formuese nuk është tërësisht në përputhje me VKM 41/2018, i ndryshuar, pasi kategoritë C dhe D nuk përputhen me VKM.</i></p> <p><i>Për sa më lart, GVJ rekomandon që të rishikohet shpërndarja e ECTS-ve të lëndëve në kategori duke respektuar peshën e tyre sipas VKM Nr. 41/2018, i ndryshuar. Përqindja e lëndëve të kategorisë A+B nuk duhet të jetë më pak se 60%; në këtë program studimi këto dy kategori përbëjnë 64.17%.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe	Programi MSH në "Teknikë Laboratori Mjekësor" zhvillohet në DTLMI, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. FSHMT është organizuar bazuar në ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë". Autoritet drejtuese janë dekani dhe drejtuesit e

<p>strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>departamenteve, koordinatori i programit. Në përbërje të tij janë 3 njësi bazë: Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri dhe Qendra e promovimit të Shëndetit, njësitë ndihmëse si laboratorë mjekësorë, dhe administrata që është në nivel universiteti (sekretaria mësimore, biblioteka, burimet njerëzore, financa, IT) personeli ndihmës mësimor shkencorë për laboratorët mësimorë dhe klinikë.</p> <p>Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri ka angazhuar në programet e studimit staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc dhe staf ndihmës akademik/laborant.</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022 departamenti përbëhet nga: 32 personel akademik, prej të cilëve 13 PAE, me kualifikimin: 1 Prof.As, 2 Dr. dhe 10 Msc.; dhe 19 PAK, me kualifikimin: 2 Prof.As, 5 Dr., dhe 12 Msc. Gjithashtu Departamenti ka 3 personel ndihmës akademik.</p> <p>Për vitin akademik 2022 -2023 departamenti përbëhet nga: 33 personel akademik, prej të cilëve 14 PAE, me kualifikimin: 1 Prof.As, 3 Dr. dhe 10 Msc.; dhe 19 PAK, me kualifikimin: 3 Prof.As, 4 Dr., dhe 12 Msc. Gjithashtu Departamenti ka 1 personel ndihmës akademik.</p> <p>Evidenca 7. Tabela përmbledhëse, tabela 1 dhe 2.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Njësia bazë ku realizohet ky program studimi ka angazhuar staf akademik dhe ndihmës akademik mësimor për realizimin e praktikave mësimore laboratorike, praktikave profesionale. Stafi ndihmës akademik asiston pedagogët për realizimin e programit mësimor. Për realizimin e programit Msc në “Teknikë Laboratori Mjekësor”, janë angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc. Pjesë e stafit të programit është stafi ndihmës akademik me karakter mësimor/laborant me formimin e duhur profesional, i cili është përgjegjës për organizimin e praktikave laboratorike mësimore dhe asiston personelin akademik në realizimin e procesit mësimor, si dhe studentët në kryerjen e procedurave të ndryshme laboratorike</p> <p>Evidenca 7. Tabela përmbledhëse, tabela 1 dhe 2.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe</p>	<p>Bazuar në rregulloren e FSHMT programi i studimit ka të emëruar koordinatorin e programit të emëruar nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekani. Koordinatorin e programit përzgjidhet nga personeli akademik i programit, mbështet hartimin e kurikulave, bashkërendon dhe mbikëqyr vëprimtarinë e programit të studimit, ndjek aktivitetin</p>

praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	shkencor të programit dhe problematikat e ndryshme dhe raporton te shefi i departamentit për realizimin e programit mësimor. Evidenca 6.4 Rregullore e Fakultetit FSHMT.			
Konkluzione	<i>FSHMT është organizuar bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe përbëhet nga 3 njësi bazë, njësi ndihmëse si laboratorët mjekësorë mësimorë dhe mbështetet nga administrata që është në nivel universiteti. Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri i cili ofron këtë program studimi, përmbush kriteret ligjore dhe standardet e cilësisë. Bazuar në rregulloren e programit të studimit Msc. në “Teknikë Laboratori Mjekësor”, programi i studimit ka koordinatoren e programit të emëruar nga dekani i FSHMT.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstaton se departamenti disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi nga petagogu i çdo lënde si dhe sekretaria mësimore. Dokumentacioni i programit të studimit përfshin: informacion për institucionin, informacion për stafin akademik, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit. Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor/ jashtë auditorit.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit Msc në “Teknikë Laboratori Mjekësor” përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 2 vite akademike të ndara në 4 semestra. Numri i ECTS është 60 ECTS për çdo vit akademik, në total 120 ECTS ose 3000 orë

	<p>mësimore prej të cilave 647 janë orë në auditor dhe 853 orë jashtë auditorit në vitin e parë dhe 726 orë janë në auditor dhe 774 jashtë auditorit në vitin e dytë.</p> <p>Plani mësimor përshin lëndet/disiplinat, praktikën dhe mbrojtjen e tezës si dhe veprimtari jashtë kurrikulare. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, laboratorëve, praktikave, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit. Frekuentimi i leksioneve dhe seminareve është i detyrueshëm në masën mbi 75%, ndërsa frekuentimi i laboratorëve në masën 100%. Një orë mësimore është 50 minuta.</p> <p>Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 11 Syllabuset.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstaton se institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit. Në takimin me studentët rezultoi që studentët kishin informacion dhe institucioni aplikon kriteret specifike përzgjedhëse në pranimin e tyre.</p> <p>Evidenca 6.2 rregullorja e FSHMT; Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit; Takimi me studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit përmban informacionin lidhur me syllabuset që zhvillon në programin MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen në leksione, seminare, praktikë mësimore/profesionle, ECTS përkatëse, literaturën përkatëse, pedagogun që zhvillon lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit dhe literaturën përkatëse. Programi ka rregullore për praktikën profesionale ku përfshihen tematika dhe udhëzime lidhur me realizimin e saj, numri i orëve të praktikës profesionale dhe ETC përkatëse. Praktika ka 12 ECTS ose 300 orë dhe kryhet në vitin e dytë.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Syllabuset janë organizuar/formatuar në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar; - Formimi profesional i pedagogut përputhet me lëndën që zhvillon. <p>Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 7 Plani mësimor, tabela 10; Evidenca 11 Syllabuset.</p>




<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Departamenti ku zhvillohet programi i studimit ka përshkruar procedurën për përmirësimin dhe përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i syllabuseve dhe literaturës për çdo lëndë. Qëllimi i rishikimit të programit është shtimi i orëve laboratorike praktike. Infrastruktura laboratorike është përmirësuar me aparatura të teknologjisë bashkëkohore në përputhje edhe me direktivat europiane. Lëndët që kanë leksione të shkruara rishikohen çdo vit dhe leksionet arkivohen së bashku me sylabuset në formë hard copy dhe elektronike në departament dhe drejtorinë e standarteve dhe kurikulave.</p> <p>Në takimin me stafin akademik u theksua se ky është një program i ri dhe janë vetëm 2 vite që funksionon, prandaj është ende herët për të bërë ndryshime. Kjo bazohet edhe në përvojën e UAL në programet e tjera, në IAL brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Evidenca 6.2 Rregullore e Fakultetit; Evidenca 7. Tabela përmbledhëse, tabela 10. Plani mësimor i programit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Dokumentacioni i programit të studimit përfshin: informacion për institucionin, informacion për stafin akademik, sylabuset e lëndëve, rregulloren e programit të studimit. Struktura e programit të studimit Msc. në “Teknikë Laboratori Mjekësor” përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr. 41/2018, i ndryshuar. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në vite akademike të ndara në 4 semestra. Numri i ECTS është 60 ECTS për çdo vit akademik, në total 120 ECTS ose 3000 orë mësimore prej të cilave 1373 janë orë në auditor dhe 1627 orë jashtë auditorit. Plani mësimor përshin lëndët/disiplinat, praktikën dhe mbrojtjen e tezës si dhe veprimtari jashtë kurrikulare.</p> <p>Programi i studimit përmban informacionin lidhur me sylabuset që zhvillon në programin Msc në “Teknik Laboratori Mjekësor”. Formimi profesional i pedagogut përputhet me lëndën që zhvillon.</p> <p>Institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ ose punësimin e studentëve.	Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të “Teknikë Laboratori Mjekësor” të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional të studentit. Orët e praktikës mësimore në laboratorët didaktikë dhe praktikës profesionale pranë laboratorëve mjekësorë përbëjnë 25% të orëve në auditor. Evidenca 7. Tabela përmbledhëse /tabela 10. Plani mësimor.
Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre. Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orë mësimore përputhet me profilin e programit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”. Në vitin e parë zhvillohen lëndë të formimit të përgjithshëm dhe bazë në “Teknikë Laboratori Mjekësor” si dhe formim profesional. Në vitin e dytë zhvillohen lëndë të formimit profesional dhe praktika profesionale. Numrin më të madh të krediteve e kanë lëndët e formimit profesional. Nga 120 ECTS lëndët e formimit profesional zënë 90 ECTS (75%). Studentët kanë mundësi të aftësohen me shprehitë profesionale praktike gjatë zhvillimit të praktikave laboratorike mësimore ku ata në mënyrë të pavarur familjarizohen me teknologjinë dhe aparaturat mjekësore dhe metodat që aplikohen në diagnozën laboratorike. Në programin mësimor studentët në semestrin e dytë të vitit të dytë zhvillojnë praktikën profesionale pranë institucioneve shëndetësore publike apo jo publike bazuar në marrëveshjet që ka Universiteti “Aldent”. Evidenca 7. Tabela përmbledhëse.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e	Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është i njëjtë me programe të ngjashme ndërkombëtare dhe kombëtare.

<p>programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Ngjashmëria me programe të njëjta në vende të BE vërehet dhe gjatë njehësimit të diplomave të studentëve që punojnë në vende të ndryshme të BE.</p> <p>Evidenca 7. Tabela përmbledhëse. RVB; Takimi me stafin drejtues të FSHMT dhe stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja në kategori sipas veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre bazuar në legjislacionin në fuqi, ngjashmëria e programit me programe në IAL të tjera, ndikon në arritjen e objektivave të programit, mobilitetin e studentëve në programe të tjera studimi të ngjashme. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij ju krijon mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat brenda dhe jashtë vendit. Në takimin me stafin akademik dhe studentët u referua se një numër studentësh të këtij programi kanë kryer mobilitet në programet Erasmus dhe u janë njohur të gjitha ECTS e fituara në universitetet pritëse.</p> <p>Evidenca 7 Tabela përmbledhëse/Plani mësimor, Takimi me stafin akademik, Tabela 10 e dhena mbi mobilitetin e studentev dhe stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>FSHMT dhe njësitë bazë kanë një praktikë lidhur me rishikimin në mënyrë të vazhdueshme të programit apo syllabuseve të lëndëve duke u bazuar në literaturë ndihmëse dhe të detyruar. Programi i studimit ju siguron studentëve literaturën bazë që janë tekse mësimorë të pedagogëve të UAL, cikle leksione të shkruara të përgatitura nga pedagogët e lëndës. Tekstet mësimore për pjesën teorike, seminare, laboratore, ushtrime propozohen nga titullarët e lëndëve dhe miratohen nga departamenti. Ky informacion gjendet në fund të çdo syllabusi.</p> <p>Evidenca 11 Syllabuset; Evidenca 6.4 Regullorja e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit i shërben rritjes së kapaciteteve profesionale në fushën Teknikë Laboratori Mjekësor, aftësimin profesional teorik dhe praktik në zgjidhjen e situatave laboratorike klinike, kryerjen e procedurave laboratorike.</p> <p>Evidenca 7 Tabela përmbledhëse, Evidenca 6.4 Regullorja e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të</p>	<p>Përmbajtja e programit i shërben studentëve për fitimin e njohurive bazë në Teknikat Laboratorike dhe metodat diagnostike laboratorike dhe</p>




studimeve dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	thellimin e njohurive të përftuara në këtë program studimi në kualifikime të mëtejshme apo ndjekje të doktoraturës. Lëndët/modulet që studenti zhvillon në këtë program studimi përbëjnë bazën për përfitimin e kompetencës profesionale për punësimin e tyre dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës. Evidenca 5. Strategjia UAL; Evidenca 6.4 Regullorja e programit të studimit.			
Konkluzione	<p><i>Programi u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fushën e "Teknikë Laboratori Mjekësor" të përshtatura me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p><i>Programi i studimit i jep rëndësi të veçantë formimit praktik profesional të studentit. Numrin më të madh të krediteve, 90 ECTS e kanë lëndët e formimit profesional.</i></p> <p><i>Programi i studimit ju siguron studentëve literaturën bazë që janë tekste mësimore të pedagogëve të UAL, cikle leksione të shkruara të përgatitura nga pedagogët e lëndës. Lëndët/modulet që studenti zhvillon në këtë program studimi përbëjnë bazën për përfitimin e kompetencës profesionale, për punësimin e tyre dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës. Laboratorët mjekësorë që janë në dispozicion të studentëve ju mundësojnë aftësimin profesional si dhe familjarizimin me teknologjinë dhe metodat laboratorike diagnostike.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti çdo fillim viti akademik bën përditësimin e programit të studimit dhe për përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Në këtë proces një vend të rëndësishëm zënë dhe informacionet e marra gjatë takimeve me përfaqësues nga institucione të tjera të IAL me profil mjekësor në vendin tonë, laboratorët mjekësor ku kryejnë praktikën profesionale, alumni me medimet e tyre pas përballjes me tregun e punës. Evidenca 5.1 Studim tregu; Evidenca 25 Marreveshjet e bashkëpunimit; Takimi me stafin akademik.




<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Pjesë e rishikimit apo përditësimit të programit mësimor janë dhe propozimet e bëra nga studentët e licencuar si teknik laborator mjekësor. Anë pozitive është përfshirja në këto konsultime edhe e studentëve të punësuar në struktura shëndetësore. Mbështetja e studentëve dhe përfshirja e tyre në përmirësimin e programeve realizohet me anë të përfshirjes së studentëve në bordin e administrimit, këshilli studentor, senatin akademik.</p> <p>Institucioni ka një databazë për studentët që ndjekin studimet në programet e studimit si dhe për studentët e diplomuar prej të cilëve merr dhe informacion për kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë në punësimin e studentëve.</p> <p>Takimi me studentët dhe stafin akademik; Evidenca 12.5 Rregullore e Këshillit Studentor.</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Çdo vit akademik njësia bazë ku zhvillohet ky program studimi bën rishikim, përditësim të kurikulave.</p> <p>Një vend të rëndësishëm në këtë proces zënë shkëmbimet e eksepriencave me programe të njëjta të stafit akademik dhe studentëve, organizimet e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar nga fusha e biznesit apo urdhërat profesionale në fushën e shëndetit.</p> <p>Takime me stafin akademik, Evidenca 10. Te dhenat Mbi mobilitetin e stafit dhe Studenteve. Evidenca 8. Lista e aktiviteteve ekstrakurrikulare. Evidenca 19. Trajnimet mbi mesimdhënie për stafin UAL.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti çdo fillim viti akademik bën përditësimin e programit të studimit dhe përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Institucioni përfshin në procesin e rishikimit të kurikulave studentët me anë të mekanizmave të ndryshme si plotësimi i përvitshëm i pyetësorëve, përfshirjen e përfaqësuesve të tyre në senatin akademik, këshilli studentor. Një anë pozitive është përfshirja në këto konsultime edhe e studentëve të punësuar në struktura shëndetësore.</i></p> <p><i>Institucioni ka një databazë për studentët që ndjekin studimet në programet e studimit dhe që janë të punësuar prej të cilëve merr dhe informacion për kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë në punësimin e studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>




Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor” ka si objektiv kryesor formimin profesional dhe shkencor bashkëkohor të studentëve, orientimin e teknikëve të laboratorit drejt kërkimit shkencor dhe ofrimin studentëve të një diplome cilësore në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke u mbështetur në prioritet strategjike dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Evidenca 5 Strategjia e UAL.
Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia kryesore dhe bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin mësimdhënies, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencor duke respektuar opinionet, idetë dhe metodat në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik dhe krijues të procesit të mësimdhënies, aktivitetit kërkimor shkencor dhe veprimtarive të tjera akademike. Institucioni bashkëpunon me IAL brenda vendit dhe institucione homologe jashtë si Çeki, Poloni, Turqi etj., në kuadër të mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik për mësimdhënie ose aktivitete të tjera sipas interesave akademike. Një vend të rëndësishëm gjatë vitit akademik zënë dhe aktivitete kulturore dhe sportive si shkolla verore e dimërore, kampionatet sportive brenda UAL dhe me IAL të tjera. Evidenca 18 Lista e aktiviteteve ekstarkurikulare.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit i motivon studentët të përfshihen në punë të mirëfilltë projektuese dhe kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor. Studentët janë angazhuar në organizimin dhe pjesëmarrjen e tyre në seminare, konferencave shkencore studentore, jo vetëm të UAL po edhe jashtë tij. Institucioni siguron pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve në trajnime dhe konferenca të tjera në mënyrë aktive me punimet e tyre ose duke sponsorizuar në zhvillimin e këtyre aktiviteteve. Pedagogët dhe udhëheqësit shkencorë i mbështesin studentët për publikimin e punimeve të kryera. Evidenca 13 Aktivitetet shkencore të UAL.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron	Në takimin me stafin akademik u referua se institucioni ka në buxhet një fond të veçantë për aktivitetet kërkimore shkencore, trajnime të stafit dhe studentëve dhe aktivitete brenda dhe jashtë vendit. Bazuar në kërkesat e departamentit për aparatura, bazë materiale apo botim

të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	librash, institucioni parashikon çdo vit një buxhet të veçantë dhe mbështet financiarisht për realizimin e punëve kërkimore shkencore. Evidenca 14 Mbështetja financiare UAL; Evidenca 6.7 Rregullorja e KPKSH.			
Konkluzione	<i>Njësia kryesore/bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin mësimdhënies, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencore. Institucioni organizon konferenca shkencore dhe ju siguron pjesëmarrjen stafit akademik dhe studentëve të marrin pjesë në trajnime dhe konferenca të tjera në mënyrë aktive ose jo duke sponsorizuar në zhvillimin e këtyre aktiviteteve. Institucioni mbështet financiarisht stafin akademik në aktivitetin kërkimor shkencor duke ju siguruar infrastrukturën dhe bazën materiale për realizimin e temave të kërkimit shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	UAL i kushton një rëndësi të veçantë harmonizimit të aktivitetit mësimor me atë kërkimor shkencor ku një vëmendje të veçantë i kushtohet përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor. Institucioni ka investuar për ndërtimin e ambienteve mësimore të paisur me teknologji të mirëfilltë laboratorike bashkëkohore për realizimin e eksperimenteve të kërkimit shkencor siç janë laboratorët mësimore të mikrobiologjisë, dy laboratorë biokimik klinik, laboratorit të anatomisë patologjike, apo nëpërmjet aplikimit dhe fitimit të projekteve të financuara nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare. FSHMT për realizimin e punëve kërkimore shkencore ka marrëveshje bashkëpunimi me strukturat spitalore rajonale. Evidenca 25 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe	Për realizimin e objektivave të kërkimit shkencor institucioni ka njësinë e kërkimit shkencor dhe projekteve e cila informon stafin për thirjet e projekteve me fonde nga burime jashtë institucionet. Kjo njësi asiston stafin në shkrimin dhe përgatitjen e projekteve dhe pas miratimit

<p>studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>monitoron zbatimin dhe realizimin e tyre. Pjesë e këtyre projekteve janë dhe studentët e të tre cikleve të studimit.</p> <p>Takimi me njësinë e kërkimit shkencor dhe projekteve dhe stafin akademik; Evidenca 6.1 Regullorja e Universitetit Aldent.</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Pjesë e rëndësishme e aktivitetit mësimor dhe kërkimor shkencor është organizimi i aktiviteteve trainuese, seminareve dhe konferencave nga njësia kryesore në fusha dhe probleme të veçanta të mjekësisë. Në këto aktivitete UAL ka qenë organizatore ose partnere. Një vend të rëndësishëm zënë dhe ditët e hapura, leksionet e hapura me pedagogë të ftuar, ku studentët janë pjesëmarrës aktive në këto aktivitete nëpërmjet paraqitjes së temave të studimit, rezultateve të projekteve ku kanë qenë pjesëmarrës me pedagogët e tyre apo botime në revista shkencore të universitetit.</p> <p>Evidenca 13 Aktivitetet shkencore në UAL; Evidenca 19 Trajnime mbi mësimdhënien për stafin akademik UAL.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit bazuar në objektivat dhe misionin e tij synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e “Teknikë Laboratori Mjekësor” dhe përgatitjen e teknikëve laborator mjekësor për ofrimin e shërbimeve laboratorike nëpërmjet aftësisë dhe kompetencës profesionale, zhvillimit të aftësive të komunikimit midis stafit mjekësor, pacientëve dhe familjarëve të tyre të nevojshme për tu përshtatur me tregun e punës brenda vendit apo jashtë tij.</p> <p>Evidenca 7 Tabela përmbledhëse/Plani mësimor.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Nuk aplikohet për këtë program studimi</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional</i></p>	<p>Programi i studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor” përputhet me aktet ligjore në vend, direktivat dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për profesionet e rregulluara.</p>




<i>Qualifications Directive, 2005/36/EU).</i>				
Konkluzione	<p><i>Institucioni ka investuar për ndërtimin e ambienteve me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor si dhe është pajisur me teknologji të mirëfilltë laboratorike bashkëkohore për realizimin e temave të diplomës, detyra kursi siç janë laboratorët mësimorë të mikrobiologjisë, dy laboratorë biokimik klinik, laboratorit i anatomisë patologjike.</i></p> <p><i>Programi i studimit ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e “Teknikë Laboratori Mjekësor”, përgatitjen e teknikëve të laboratorit për ofrimin e shërbimeve laboratorike, aftësimin profesional, nëpërmjet aftësimin dhe kompetencës profesionale, zhvillimit të aftësive të komunikimit midis stafit mjekësor dhe pacientëve të nevojshme për tu përshtatur me tregun e punës brënda vëndit apo jashtë tij.</i></p> <p><i>Institucioni ka njësinë e kërkimit shkencor dhe projekteve e cila informon stafin për thirrjet e projekteve me fonde nga burime jashtë institucionit.</i></p> <p><i>UAL ka një harmonizim të aktivitetit mësimor me atë kërkimor shkencor ku një vëmendje të rëndësishme zë përfshirja e studentëve në kërkim shkencor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Për realizimin e procesit mësimor UAL përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, tema diplome si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në Poëer Point, biseda interaktive me studentët apo temave të veçanta nga studentët dhe diskutimi i tyre. Stafit akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimin apo praktikës mësimore.</p> <p>Takime me stafin akademik dhe studentet; Evidenca 19 Trajnime stafi UAL.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre ne funksion të formimit të tyre profesional teorik. Për zhvillimin e praktikave laboratorike mësimore institucioni ka krijuar infrastrukturë laboratorike të pajisur me aparatura dhe teknologji bashkëkohore, të cilat ju shërbejnë studentëve për aftësimin e tyre praktik profesional.</p> <p>RVB; Evidenca 15.1 Përshkrimi i laboratorëve; Takimi me stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesëmarrje në programe bashkëpunimi për shkëmbim eksperience midis IAL në kuadër të programeve Erasmus, konferenca shkencore, aktivitetet trajnuese sipas shkallës së kualifikimit, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike.</p> <p>Evidenca 14 Mbeshtetje financiare stafi UAL; Evidenca 14.3 Politikat e Mbeshtetjes Financiare; Evidenca 10 Te dhenat mbi mobilitetin e stafit dhe studenteve.</p>

30

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale dhe eksperiencë mjekësore apo pedagogjike në lëndët që zhvillon. GVJ, nga vlerësimi i dokumenacionit, konstaton se formimi profesional përputhet me lëndën që zhvillon në këtë program studimi.</p> <p>Për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqës për studentin institucioni i mundëson stafit akademik përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies si projektorët, prezantime poëer point, metoda interaktive. Siç është theksuar edhe në standardet e mësipërme, IAL ka investuar në krijimin e infrastrukturës së nevojshme laboratorike për demonstrimin e praktikave mësimore.</p> <p>Evidenca 15.1 Përshkrimi i laboratorëve; Evidenca 22.2 CV Stafit Akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin dhe metodat e mësimdhënies nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve të stafit akademik, formularëve të vlerësimit të performancës së stafit akademik, ndjekjen e zhvillimit të procesit mësimor nga NJSBC. Në këtë proces janë përfshirë edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vlerësimit apo përfaqësimit të tyre në struktura drejtuese si senati akademik. Gjatë takimit me stafin dhe në RVB theksohet se departamentet organizojnë takime të vazhdueshme dhe konsultime në lidhje me format më efektive të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca 21.2 Pyetësori i Stafit Akademik. Evidenca 22.4.1 Formulari i performances akademike. Evidenca 21.3 pyetësore me studentët. Takimi me stafin.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të</p>	<p>Institucioni ka të organizuar me akte rregullatore mënyrën e funksionimit të UAL/Fakulteteve/departamenteve/programeve mësimore të cilat janë në funksion të organizimit të mësimdhënies në programe të ndryshme që ka UAL. Njësitë kryesore që asistojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencorë janë NJSBC dhe kurikulave, zyra e projekteve, përmes trajnimeve dhe projekteve të vazhdueshme ku përfshihet stafi akademik. NJSBC dhe kurikulave është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional. Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, shërbejnë dhe leksionet e hapura të organizuar nga departamentet, pjesëmarrja e lektorëve të jashtëm nga fusha e biznesit, trajnimet periodike të stafit akademik. Stafi akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënies për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqëse për studentin si me anë të</p>




mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	projektorëve, prezantime poëer point, paraqitjen e materialeve audiovizive, metoda interaktive, organizmin e leksioneve të hapura me pedagogë dhe ekspert të jashtëm. Evidenca 21.1.1 Rregullore e NJSBC; Evidenca 19 Trajnimet mbi mesimdhënien per stafin UAL.			
Konkluzione	<p><i>UAL përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, tema diplome si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti.</i></p> <p><i>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike të ndryshme ne funksion të formimit profesional teorik dhe praktik të studentëve.</i></p> <p><i>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale dhe eksperiencë mjekësorë apo pedagogjike në lëndët që zhvillon, ku formimi i tyre profesional përputhet me lëndën që zhvillon në këtë program studimi.</i></p> <p><i>NJSBC dhe Zyra e kurrikulave është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/ Rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumnetacionit të vënë në dispozicion dhe takimet e zhvilluara në institucion me studentët, pedagogë dhe stafin mbështetës konstatoi se vlerësimi i njohurive të studentëve dhe aftësive profesionale të stafit bazohen në Rregulloret e institucionit miratuar nga Rektori. Studentët njihen me këto rregullore gjatë tureve të orientimit të studentëve, nga koordinatori e programit si dhe nga pedagogu i lëndës në fillim të syllabusit përkatës.</p> <p>Takimi me studentët, pedagogët dhe stafin mbështetës; Evidenca 6.3 Rregullore Departamenti; Evidenca 6.4 Rregullore e programit te studimit.</p>

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/ moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.</p>	<p>Në fillim të lëndës pedagogu prezanton syllabusin e lëndës, mënyrën e realizimit të procesit mësimor, tematikën e leksioneve, seminareve dhe praktikave laboratorike dhe orët mësimore përkatëse sipas ECTS që ka lënda. Pedagogu informon studentin për mënyrën e frekuentimit të procesit mësimor dhe vlerësimit të dijeve. Frekuentimi i procesit mësimor (leksione, seminare) është detyrueshëm në masën mbi 75% të orëve, frekuentimi laboratorëve mësimore dhe praktikës profesionale në masën 100%. Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme sipas rregullores së FSHMT dhe rregullores së programit mësimor. Gjithë informacioni ju vihet në dispozicion studentëve nga pedagogu i lëndës dhe në çdo syllabus.</p> <p>Takimi me stafin; Evidenca 6.2 Rregullorja e FSHMT; Evidenca 6.4. Rregullore e programit te studimit; Evidenca 11 Syllabuset e programit.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Provimet dhe riprovimet zhvillohen ne 3 sezone: sezoni i dimrit, verës vjeshtës. Me propozim të departamentit dhe miratim të dekanatit organizohen dhe sezone të posaçme provimi.</p> <p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale kryhet në mënyrë të vazhdueshme sipas tipologjisë së lëndëve</p> <p>Sistemi i vlerësimit është përshkruar në Syllabuset përkatëse dhe gjithashtu në Kapitullin “Kontrolli i njohurive” të “Rregullores së programit të studimit”.</p> <p>Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar.</p> <p>Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi i vlerësimit me pikë të cilat konvertohen me 10 nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal si në vijim:</p> <p>0-40 pikë: nota 4; 41-50 pikë: nota 5; 51-60 pikë: nota 6; 61-70 pikë: nota 7; 71-80 pikë: nota 8; 81-90 pikë: nota 9; 91-100 pikë: nota 10.</p> <p>Nota më e ulët për kalim në një lëndë është nota 5 (pesë).</p> <p>Evidenca 6.4. Rregullore e programit te studimit; Evidenca 11 Syllabuset e programit.</p>




Konkluzione	<p><i>Frekuentimi i procesit mësimor dhe vlerësimi i dijeve të studentit bazohet në rregulloren e programit të studimit.</i></p> <p><i>Studenti njihet me frekuentimin e programit mësimor dhe vlerësimin e dijeve nga pedagogu i lëndës në fillim të syllabusit përkatës. Në çdo syllabus paraqitet dhe mënyra e vlerësimit nga pedagogu.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.</p>	<p>Institucioni zotëron të gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe ju vihet këtyre të fundit në dispozicion nga pedagogu i lëndës dhe në çdo syllabus. Vlerësimi i studentit është i vazhdueshëm dhe gjithëvjetor dhe ndahet në disa zëra si aktivizimi, vlerësimi në kolokiume, praktika laboratorike etj.</p> <p>Evidenca 6.1 Rregullore e Universitetit Aldent; Evidenca 6.4. Rregullore e programit të studimit; Evidenca 6.2 Rregullorja e FSHMT; Evidenca 11 Syllabuset e programit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Universiteti UAL përdor provimin me shkrim për lëndët mjekësore me teza ku ka kombinim të pyetjeve zhvilluese, rasteve klinike apo kuiceve. Sistemi elektronik përdoret vetëm në lëndët e informatikës.</p> <p>Takimi me stafin akademik dhe drejtuesit e FSHMT.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve të studentit bëhet sipas rregullores së FSHMT dhe rregullores së programit të studimit. Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik me qëllim që të mundësojë studimin sistematik të studentit, të vlerësojë ecurinë e procesit mësimor dhe shkallën e asimilimit të lëndës nga studenti si dhe një vlerësim më objektiv të studentit duke e ndarë notën në disa komponentë dhe jo vetëm në provim përfundimtar. Elementë kryesorë të kontrollit të vazhdueshëm janë: niveli i aktivizimit në seminare, vlerësimi në kolokiume, praktika laboratorike, etj.</p>

	<p>Vlerësimi i dijeve bëhet në provim të ndërmjetëm, provim përfundimtar, riprovim dhe provim të përmirësimit. Teza e provimit hartohet nga pedagogu i lëndës dhe vlerësimi i dijeve bëhet me sistemin e pikëve që konvertohen në nota ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 maksimale.</p> <p>Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 6.2 Rregullorja e FSHMT.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Tesimi i dijeve përfundimtare realizohet nga pedagogu që ka zhvilluar lëndën. Procedura e kryerjes së provimit bazohen në rregulloren e programit të studimit. Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e procesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Studenti paraqitet në provim me dokument identifikues dhe çdo objekt që ka me vete vendoset në një vend të caktuar nga organizatorët. Në provim janë të pranishëm pedagogët e lëndës, sekretaria që kryhen sekretimin, monitorues nga departamenti dhe dekanati. GVJ nga verifikimi me sondazh i fletëve të provimit dhe takimi me përfaqësuesit e kurrikulave konstatoi se provimi zhvillohet me komision të përbërë minimumi nga dy anëtarë/pedagogë.</p> <p>Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 6.2 Rregullorja e FSHMT.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/ nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>UAL ka hartuar rregullore të posaçme për organizmin e provimeve. Provimet realizohen në auditore sipas kalendarit dhe auditorëve të përcaktura nga sekretaria mësimore dhe departamenti ku realizohet programi i studimit. Procesi i provimit mbikqyret nga pedagogët e lëndës të cilët janë dhe përgjegjës kryesorë për zbatimin e rregullores për mbarvatjen e provimit.</p> <p>Takimi me stafin akademik, drejtues të FSHMT; RVB; Evidenca 12.1 Procedurat e provimeve.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Realizimi i provimit dhe komunikimi i rezultateve bëhet sipas rregullores së programit të studimit. Rezultatet komunikohen brenda 6 ditëve nga dita e zhvillimit të provimit, ju komunikohen studentëve në mënyrë individuale nga pedagogu i lëndës dhe hidhen në sistemin online nga sekretaria mësimore. Studenti mund të rishikojë tezën nëse nuk është i kënaqur me vlerësimin në prani të pedagogut.</p>




	Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 6.2 Rregullorja e FSHMT; Evidenca 12.2 Rregullorja e sekretarisë.			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve. Takimi me studentët; Evidenca 12.1 Procedurat e provimeve.			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Për çdo provim pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejtë të kryejnë kërkesë për rishikimin e notës duke dorëzuar në departament kërkesë me shkrim për rivlerësim. Departamenti cakton një datë për të parë tezën në prani të pedagogut të lëndës. Ata që kanë ankesa rimerren në provim nga një komision i posaçëm. Rezultati i komisionit të rivlerësimit është i padiskutueshëm dhe i komunikohet studentit dhe pedagogut. Proçesverbali i komisionit firmoset dhe dërgohet në sekretarinë mësimore dhe arkivohet. Evidenca 12.1 Procedurat e provimeve; Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 6.2 Rregullorja e FSHMT.			
Konkluzione	<i>Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik. Vlerësimi i dijeve bëhet me provim të ndërmjetëm, provim përfundimtar, riprovim dhe provim të përmirësimit.</i> <i>Rezultatet e provimit ju komunikohen studentëve në kohë duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit.</i> <i>Studenti ka të drejtën e ankimimit të rezultatit. Proçedura e ankimimit kryhet sipas rregullores së programit të studimit, Departamentit dhe rregullores së provimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master shkencor “Teknikë Laboratori Mjekësor” është me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe ka 120 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore – 50 minuta. 1 ECTS = 25 orë punë studenti në auditor dhe ashtë auditorit. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione seminare, praktika laboratorike, detyra kursi, apo prezantime apo praktika profesionale.</p> <p>Organizmi i programit mësimor si dhe kurikulat e programit/ sylabuset/ lëndët mësimore mundësojnë formimin profesional të thelluar dhe zhvillim të aftësive të vecanta si aftësi organizative, kërkim të pavarur shkencor, punën në grup etj.</p> <p>Evidenca 6.4 rregullorja e programit të studimit; Evidenca 6.2 Rregullorja e FSHM; Evidenca 7, Tabelat përmbledhëse/plani mësimor.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Pjesë të programit mësimor përveç lëndëve të formimit profesional janë dhe ato të formimit të përgjithshëm si psikologji shëndeti, metodat e kërkimit shkencor dhe statistikë, sistemi i menaxhimit laboratorik, komunikimi profesional.</p> <p>Evidenca 7, Tabelat përmbledhëse/plani mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe sylabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.</p>	<p>Masteri shkencor në “Teknikë Laboratori Mjekësor” synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në profilin përkatës dhe të formojë Teknikë laboratorit me kompetencën e nevojshme profesionale teorike dhe praktike në fushën e mjekësisë laboratorike për realizimin e misionit të “Teknikë Laboratori Mjekësor” për sigurimin e testimeve të sakta me siguri maksimale të mundshme dhe të besueshme. Gjithashtu një element i rëndësishëm i programit është pajisja e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe kërkimit për të cilën zhvillohet dhe një lëndë e vecantë në kurikulën e programit. Në përfundim të lëndëve të vecanta një vend të rëndësishëm zë dhe diskutimi me studentët i përmbajtjes së sylabuseve, sa ju ka shërbyer ky program studimi në formimin e tyre profesional, përfundimit të aftësive dhe kompetencave në kryerjen e detyrave si dhe marrjen e mendimit dhe sygjërimeve të studentëve për përmirësimin e programit të studimit. Në përfundim të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme orën e fundit të mësimin, si dhe orienton studentët ku duhet të</p>




	<p>fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Gjithashtu pedagogu ndalet në veçanti në temat që kanë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të studentëve.</p> <p>Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit; Takimi me stafin akademik dhe studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/ çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kane mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit, mjekësisë laboratorike apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet tyre. Një vend të rëndësishëm në program zë praktika laboratorike mësimore dhe praktika profesionale në institucionet shëndetësore publike apo private ku studentët shohin praktikisht teorinë e marrë në auditor dhe fitojnë aftësi dhe kompetencë për ushtrimin e profesionit të “Teknikë Laboratori Mjekësor”. Një ndër mënyrat që motivon studentët në asimilimin e programit mësimor është dhe puna e pavarur e studentit, puna në grup gjatë seminareve apo aktiviteteve trajnuese të cilat ju mundësojnë studentëve aftësitë organizuese dhe drejtuese, komunikimit me etikë midis kolegëve. Në zhvillimin e procesit mësimor liria akademike që siguron institucioni, ju mundëson pedagogëve përdorimin e metodave të ndryshme në mësimdhënie, në punimin e temave të diplomës. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentë në bashkëpunim me pedagogët. Këtij qëllimi i shërbejnë angazhimi që UAL ka me programet Erasmus + dhe Ceepus për mobilitetin e studentëve dhe të stafeve akademike.</p> <p>Evidenca 19 Trainime të stafit akademik; Takim me stafin akademik dhe studentët.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vitit akademik bazuar në kalendarin e aktiviteteve të përgatitur nga zyra e Këshillimit të karrierës, organizohen aktivitete si leksione të hapura, seminare trajnuese me stafin akademik duke u updatuar me zhvillimet apo të rejat e shkencës dhe teknologjisë në fushën përkatëse, trajnime për metodat e mësimdhënies online, zhvillim të provimeve online, tema sociale, etj.</p> <p>Evidenca 19 Trajnime per stafin akademik UAL.</p>




<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Institucioni mbështet financiarisht studentët për zhvillimin e temave të diplomës apo studime duke i financuar për pjesëmarrjen në konferenca studentore ndërkombëtare si dhe publikim të punimeve të tyre në Buletinin Shkencor periodik.</p> <p>Evidenca 16 Libri i abstrakteve konferenca studentore; Takimi me studentët</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Organizmi i programit mësimor si dhe kurrikulat e programit/ sylabuset/ lëndët mësimore mundësojnë formimin të thelluar profesional dhe zhvillim të aftësive të veçanta si aftësi organizative, kërkim të pavarur shkencor, punën në grup, menaxhimin shëndetësor, etj.</i></p> <p><i>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kane mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet tyre.</i></p> <p><i>Programi Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor” ka patur shkëmbime eksperiencë me studentë dhe pedagogë në kuadër të marreveshjes me universitete në Poloni, Ankara, Ceki, Lituani etj. të financuar nga Erasmus+.</i></p> <p><i>Institucioni mbështet financiarisht studentët për zhvillimin e temave të diplomës apo studime duke i financuar për pjesëmarrjen në konferenca studentore ndërkombëtare si dhe publikim të punimeve të tyre në Buletinin Shkencor periodik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studenti me përfundimin e studimeve pajiset me diplome Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor”, pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur mikrotezën. Rregullorja e punimit të temës së diplomës mbart informacione të detajuara për mënyrën e shkrimit të temës së diplomës. Proçedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës</p>




	<p>bazohet në regulloren e UAL dhe të programit të studimit. Komisioni vlerësimi ngrihet në bazë departamenti dhe përbëhet nga 5 anëtarë.</p> <p>Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 12.1 Procedurat e provimeve.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Fokusi i programit Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor” është përvetësimi i aftësive praktike profesionale dhe kompetencave në ushtrimin e profesionit nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar/tema e diplomës si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në përgatitjen e një teme diplome. Studentët asistohen nga pedagogët e programit të studimit në zgjedhjen e temës së diplomës. Tema e diplomës dhe pedagogu udhëheqës caktohen në vitin e parë.</p> <p>Evidenca 8.1 Modaliteti i diplomës; Evidenca 8.2 Ndarja e temave të diplomës; Takimi me studentët dhe stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Temat propozohen nga departamenti dhe lista e tematikave të propozuara i paraqiten studentëve dhe udhëheqësve të tyre. Zgjedhja e temës e cila ka karakter aplikativ/praktikë bëhet nga studentit dhe pedagogu udhëheqës. Vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet nga komisioni prej pesë anëtarësh i miratuar nga dekani. Vlerësimi bazohet në rezultatet e studentit por peshën më të madhe e zë punimi dhe prezantimi i diplomës.</p> <p>Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në realizimin e temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët ndihma e të cilëve konsiston në zhvillimin e seancave konsultuese që janë orë pune që ndihmojnë studentin në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, metodologjinë e hartimit, shkrimin apo prezantimin e punimit të diplomës. Seancat konsultuese zhvillohen nga pedagogu udhëheqës i temës dhe kanë karakter interaktiv. Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e pjesës teorike të temës së diplomës infrastrukturën e nevojshme si dhe ju garanton studentëve mbledhjen e të dhënave apo realizimin e testeve të ndryshme në funksion të temës në institucionet shëndetësore me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>

40

	Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 8.3 Formular aplikimi për temë diplome; Takimi me stafin akademik.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Përcaktimi i temave të diplomës bëhet nga departamenti ku zhvillohet programi studimit, në fillim të vitit të dytë akademik. Temat përcaktohen nga pedagogët në diskutim me studentët. Studentët asitohen nga pedagogët dhe stafi i sekretarisë në caktimin e temës së diplomës, zgjedhjen e udhëheqësit dhe plotësimin e formularit të aplikimit për temën e diplomës. Aplikimet shqyrtohen në departament dhe miratohen nga dekani. Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Pedagogu udhëheqës si dhe pedagogu laborant udhëzon dhe orienton studentin gjatë punimit të temës, mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e rezultateve, literaturën që do shfrytëzojë dhe jep miratimin me shkrim nëse studimi është i plotë për tu paraqitur përpara komisionit të vlerësimit. Studenti dorëzon punimin e diplomës në formë fizike, elektronike dhe Poëer point. Komiteti shkencor i programit mer vendimin për mbrojtjen e temës dhe cakton datën e mbrojtjes e cila shpallet dhe publikisht. Mbrojtja bëhet përpara komisionit të caktuar nga komiteti shkencor i programit dhe miratuar nga përgjegjësi i departamentit. Vlerësimi bëhet me notë e cila është mesatare e vlerësimit të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Vlerësimi bazohet në disa kritere si cilësia e punimit, struktura e organizmit, shkrimi, mënyra e zhvillimit të ideve, cilësia e analizës dhe rezultateve të studimit, mënyra e paraqitjes, literatura etj. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Diplomave është përfundimtar dhe nuk mund të ankimohet. Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion	Në përfundim të programit të studimit pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj IAL pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion dhe kopje e plotë zyrtare e programit të studimit që ka zhvilluar në ciklin e dytë të studimeve në Master Shkencor në “Teknikë Laboratori Mjekësor”.

kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit.			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Dokumentacioni lidhur me studentët ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të japë informacion për studentët nëse kërkohet. Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit.			
Konkluzione	<p><i>Studenti me përfundimin e studimeve pajiset me diplome Master i Shkencave në "Teknikë Laboratori Mjekësor" pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur mikrotezën.</i></p> <p><i>Përgatitja e temës së diplomës dhe provimi përfundimtar bazohet në Rregulloren e programit të studimit.</i></p> <p><i>Zgjedhja e temës e cila ka karakter aplikativ/praktikë bëhet nga studenti dhe pedagogu udhëheqës. Në realizimin e temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët ndihma e të cilëve konsiston në zhvillimin e seancave konsultuese që janë orë pune që ndihmojnë studentin në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, metodologjinë e hartimit, shkrimit apo prezantimin e punimit të diplomës.</i></p> <p><i>Dokumentacioni lidhur me studentët ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të japë informacion për studentët nëse kërkohet.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimt të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për	Ky standard nuk i përket këtij programi studimi.


realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.				
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat	Ky program studimi realizohet pranë Departamentit Teknik Laboratori Mjekësor dhe Imazheri. Struktura organizative e departamentit përbëhet nga stafi akademik dhe ndihmës (sekretaria departamentit, personeli mbështetës për laboratorët).

<p>ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Departamenti Teknik Laboratori Mjekësor dhe Imazheri ka angazhuar në programin e studimit personel akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc. dhe staf ndihmës akademik/laborant.</p> <p>Konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin akademik 21-22 ka angazhuar: 8 PAE, prej të cilëve 1 Prof., 4 Prof.As., 2 Dr. dhe 1 SPA; 5 PAK, prej të cilëve 3 Prof.As. dhe 2 Dr.; - Për vitin akademik 22-23 ka angazhuar: 15 PAE, prej të cilëve 2 Prof., 3 Prof.As., 6 Dr., 1 SPA dhe 3 Msc.; 9 PAK, prej të cilëve 3 Prof.As., 2 Dr. 3 SPA dhe 1 Msc. <p><i>GVJ, duke u bazuar në këto të dhëna, evidenton që Insitucioni ka angazhuar në mësimdhënie personel akademik me Msc. gjë e cila nuk është në përputhje me nenin 59, pika 6 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Në programet e nivelit të dytë mund të angazhohet vetëm personel akademik i kategorisë lektor dhe profesor.</i></p> <p>Fusha kërkimore e personelit përputhet me lëndët që ata mbulojnë.</p> <p>Tabelat përmbledhëse, tabela 6.1 dhe 6.2.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Lidhur me ngarkesën mësimore të programit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”, në vitin akademik 2021-2022 ngarkesa ka qënë 58.9% PAE dhe 41.1% PAK, ndërsa për vitin akademik 2022-2023 stafi akademik efektiv PAE mbulon 78.8% të ngarkesës totale mësimore, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> <p>Tabelat përmbledhëse, tabela 12.1 dhe 12.2.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacion e shqyrtuar në Zyrën e Burimeve Njerëzore, Departamentin Teknik Laboratori Mjekësor dhe Imazheri ku zhvillohet program i studimit si dhe CV e stafit akademik konstaton se në vitet e fundit stafi akademik është stabil. Nga shqyrtimi me përzgjedhje rastësore të kontratave të punës konstatohet se janë paguar rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p>Evidenca 22.3 Kontratatat tip të punës; Takimi me zyrën e burimeve njerëzore.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi,</p>	<p>GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK dhe pedagogë të ri me kontratë.</p>

mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

GVJ verifikoi me përzgjedhje rastësore dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe staf i ri akademik me kontratë.

Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga Universiteti Aldent.

Procedura e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme realizohet nga njësi bazë duke propozuar komisione Ad-hoc konform bazës ligjore dhe nënligjore si dhe akteve të brendshme rregullatore të IAL. Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit. Universiteti "Aldent" përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik; procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me sistem pikëzimi.

Nga shqyrtimi me përzgjedhje rastësore të dosjeve të personelit GVJ konstatoi se është i pranishëm dokumentacioni i kërkuar.

Konkretisht, dosja e stafit akademik përmban:

1. Kontrata e punës;
2. Dokumentacionin që ka dorëzuar në momentin e aplikimit;
3. Librezën e punës;
4. CV;
5. Listë notash, Diplomë, dëshmi penaliteti, raport mjeko ligjor ;
6. Fotokopje ID.

Diplomat e gjuhës së huaj vendosen në para procesit të diplomimit.

Bazuar në statut dhe kodin e punës Institucioni ka hartuar procedurë e kritere për rekrutimin e personelit.

Çdo vit departamentet bëjnë përcaktimin e stafit akademik që përfshihet në programin e studimit, ngarkesën mësimore sipas semestrave dhe atë vjetore. Në bazë të ngarkesës mësimore departamenti bën planifikimin e pedagogëve si dhe i paraqet dekanatit nëse ka nevoja për rekrutim të stafit akademik dhe jo akademik për realizimin e programit të studimit, gjithashtu departamenti harton kriteret bazë dhe specifike.

Pasi miratohen në rektorat vendet e lira të punës shpallen në faqen e ëeb-it të universitetit ku publikohen kriteret e përgjithshme dhe specifike për vendin e punës si dhe dokumentacioni që duhet të

	<p>dorëzojë çdo kandidat, afatet kohore për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm si dhe tabela e pikëzimit të kandidatit. Pas shpalljes së vendit vakant, dekani ngre komisionin “ad hoc” që do të realizojë procedurën për rekrutimin e stafit akademik. Konkurimi kalon në dy faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësim në bazë të dosjes; 2. Intervista me gojë. <p>Kandidatët klasifikohen sipas pikëve dhe merret vendimi përkatës. Evidenca 22.4 Procedura e rekrutimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ evidentoi angazhimin e personelit ndihmës akademik të cilët asistojnë dhe realizojnë orët laboratorike, të cilët gjithashtu angazhohen në realizimin dhe mirëmbajtjen e laboratorëve, siç janë: Laboratori i Biokimisë dhe Hematologjisë, Laboratori i Mikrobiologjisë, Laboratori i Histopatologjisë. Personeli ndihmës akademik është plotësisht i mjaftueshëm dhe ka kompetencën profesionale dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij. Tabelat përmbledhëse, tabela 6.1 dhe 6.2.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se Universiteti Aldent disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit. Çdo vit Zyra e Burimeve Njerëzore bën dhe përditësimet në bazën elektronike të të dhënave dhe dokumentacionit plotësues përkatës. Institucioni ka venë në dispozicion listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore dhe kualifikimin e tyre. Evidenca 22.5 Përmbajtja e dosjes së stafit.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e orëve të praktikës profesionale sipas programit të studimit FSHMT dhe UNI ALDENT ka lidhur marrëveshje me institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor. Konkretisht GVJ evidentoi që UNI ALDENT ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet shëndetësore shtetërore dhe private siç janë Instituti i Shëndetit Publik, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Spitali Universitar i Traumës, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Laboratori Genius. Marrëveshjet kanë si qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor dhe</p>




	<p>gjithashtu realizimin e diplomës. Marrëveshjet janë të lidhura në nivel Instucional dhe zbatohen nga njësia bazë.</p> <p>Evidenca 25 Marrëveshje bashkëpunimi.</p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve/ raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Institucioni ka një procedurë të përcaktuar për përcaktimin e udhëheqësve të praktikave klinike që përzgjidhen nga drejtuesit e institucioneve ku realizohet praktika klinike në bazë të marrëveshjeve të lidhura. Personeli mbikqyrës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në programin e studimit Master Shkencor “Teknikë Laboratori Mjekësor” ndihmon studentët si në përmbushjen e detyrimeve/raportit përfundimtar të praktikës gjithashtu dhe në vlerësimin e tyre. Praktika e detyrueshme mbikëqyret bashkarisht nga mbikëqyrësi në vendin e praktikës dhe anëtari i caktuar i stafit akademik i departamentit.</p> <p>Evidenca 25 Marrëveshje bashkëpunimi; Evidenca 6.5 Rregullore e praktikës Profesionale.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Për realizimin e ngarkesës mësimore të programit MSH në Teknikë Laboratori Mjekësor janë angazhuar staf akademik efektiv dhe staf akademik me kontratë që zotërojnë tituj, grada shkencore ose janë Msc. GVJ evidenton që Institucioni ka angazhuar në mësimdhënie personel akademik me Msc. gjë e cila nuk është në përputhje me nenin 59, pika 6 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Në programet e nivelit të dytë mund të angazhohet vetëm personel akademik i kategorisë lektor dhe profesor.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se Universiteti Aldent disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit MSH në “Teknikë Laboratori Mjekësor”.</i></p> <p><i>Për kryerjen e orëve të praktikës mësimore dhe profesionale sipas programit të studimit FSHMT, Universiteti Aldent garanton mjedise të mjaftueshme dhe të mirëpajisura brenda institucionit si dhe jashtë tij, në institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit që kanë nënshkruar me këto institucione.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në instucion GVJ u njoh më mjediset e UNI ALDENT. Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standardeve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor.</p> <p>Universiteti zotëron një kampus krejtësisht të ri dhe modern me ambiente të standardeve të larta dedikuar procesit akademik, praktikave laboratorike dhe rekreacionit. UAL disponon 4 godina me mjedisa të shumta mësimore dhe gjithashtu 40 laboratore.</p> <p>Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminareve, laboratorët mësimore, laboratorë të informatikës, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë si dhe hapësirat e jashtme.</p> <p>Njësia bazë ka në dispozicion mjedise të mjaftueshme, të reja dhe moderne për zhvillimin e veprimtarisë mësimore laboratorike dhe administrative.</p> <p>Evidenca 15.2 Relacion i infrastruktures; Vizita e ambjenteve.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Ambientet e mësimdhënies janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Sallat e leksioneve dhe seminareve kanë numrin e mjaftueshëm të posteve për studentët të cilët janë të organizuarar në grupe në raport me numrin e posteve në sallë.</p> <p>Ambjentet mësimore janë me sistem kondicionimi ngrohje dhe ftohje. Në funksioin të programit janë në dispozicion mjete elektronike dhe teknologjisë së informacionit, si kompjutera dhe videoprojektorë në të gjitha sallat. Ndryçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore.</p> <p>Salla e informatikës është në shërbim të vazhdueshëm të studentëve më qëllim realizimin sa me të mirë të procesit akademik.</p> <p>Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim.</p> <p>Evidenca 15.2 Relacion i infrastruktures; Vizita e ambjenteve.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas</p>	<p>Në funksion të programit të studimit janë Laboratorët mësimorë të mirëpajisur me aparatura, mjete pune , mjete didaktike dhe reagentë</p>




<p>natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>në funksion të procedimit të metodave laboratorike përfshirë në programin e studimit. Konkretisht në funksion të programit janë Laboratori Biokimik, Klinik, Mikrobiologjik dhe i Anatomisë Patologjike. Këto Laboratore disponojnë aparatura bashkëkohore si autoanalizatorë, cell counter, spektrofotometra, mikroskope, kappa, mikroton, etj. duke mundësuar aplikimin e procedurave laboratorike nga të gjithë studentët e programit të studimit.</p> <p>Evidenca 15.1 Përshkrimi i laboratoreve; Vizita e ambjenteve.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit në Master Shkencor në Teknikë Laboratori Mjekësor është Laboratori i Teknologjisë së Informacionit. Ky laborator është i pajisur me kompjutera dhe programe profesionale për zhvillimin e laboratorëve të Informatikës dhe Statistikës dhe ka dispozicion programe bazë dhe të SPSS në funksion të përpunimeve statistikore dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Evidenca 15.1 Përshkrimi i laboratoreve; Vizita e ambjenteve.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Infrastruktura në funksion të programit të studimit është e mjaftueshme dhe sipas standardeve bashkëkohore, duke siguruar një proces mësimdhënës dhe laboratorik optimal. Për realizimin e praktikave profesionale Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore siç janë Lab Genius, Intermedika, QKT Gjakut, ISHP etj.</p> <p>Evidenca 25 Marrëveshje bashkëpunimi.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të standardeve të larta dhe plotësisht në plotësim të standardeve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor. Universiteti Aldent zotëron laboratorët mësimor të mirëpajisur me aparatura bashkëkohore në funksion të programit të studimit. Në funksion të programit të studimit në MSH Teknikë Laboratori Mjekësor është edhe Laboratori i Teknologjisë së Informacionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit, biblioteka zotëron 15.000 tituj librash profesionale. Institucioni është abonuar në bibliotekën Hinari e cila shfrytëzohet nga stafi akademik dhe studentët. Biblioteka disponon dy salla me kapacitet 75 poste leximi, 25 poste interneti që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Evidenca 23 Biblioteka dhe menaxhimi i saj.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimeve me stafin drejtues dhe në RVB thuhet se njësia përgjegjëse kontribuon vazhdimisht në përditësimin dhe pasurimin e literaturës në funksion të programit të studimit. Në bazë të kërkesave të njësisë bazë Institucioni akordon çdo vit një fond të përshtatshëm për pasurimin me literaturë bashkëkohore. Departamenti rishikon në fillim të çdo viti akademik literaturën në syllabuse me qëllim rifreskimin e tyre në bazë të traktateve mjekësore bashkëkohore.</p> <p>Takimi me stafin drejtues; Vizita e Ambjenteve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Aldent ka një Bibliotekë Universitare pranë korpusit qendror e cila ka hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët. Gjithashtu Universiteti Aldent ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të konsultohen me materiale ndërkombetare.</p> <p>Vizita e ambjenteve.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ evidentoi që Biblioteka e Universitetit ka një fond fizik të bollshëm të literaturës mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të huaja, libra apo revista shkencore. GVJ inkurajon Institucionin për rritje të vazhdueshme vit pas vitit të buxhetimit të bibliotekës me qëllim vazhdimin e pasurimit të saj.</p> <p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Universiteti Aldent ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj on-line.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të</p>	<p>Biblioteka siguron literaturë fizike dhe digjitale/on line në ndihmë të studentëve dhe stafit akademik. Gjithashtu, Universiteti Aldent ka</p>

<p>barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentet mund të konsultohen me materiale në gjuhë të huaj.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Vizita e ambjenteve.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara, dhe në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën të cilët përgjigjen për mirëmbajtjen dhe nevojave të studentëve. Studentët pajisen me kartë rregjistrimi dhe njihen me rregulloren e funksionimit të bibliotekës.</p> <p>Vizita e ambjenteve.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka menaxhohet nga një person përgjegjës i cili bën raportimin e vazhdueshëm në lidhje me përditësimet e literaturës, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe on line etj. Biblioteka është e pajisur me sistem kompjuterik të menaxhimit të titujve. Universiteti Aldent planifikon çdo vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programeve mësimore. Propozimet për tituj apo tekse vijnë nga departamentet e fakulteteve dhe përgatiten nga stafi i bibliotekës i cili përgatit listën e tekseve të kërkuara me buxhetin përkatës dhe dorëzon në rektorat. Gjatë bisedës me stafin akademik dhe studentët u deklarua se ata e shfrytëzojnë në mënyrë të kënaqshme fondin e e bibliotekës kryesisht atë on-line.</p> <p>Takimi me stafin dhe studentet.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UA ka një Bibliotekë Universitare me hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët. Gjatë vizitës GVJ evidentoi që Biblioteka e Universitetit ka një fond fizik të bollshëm të literaturës mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara, dhe në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</i></p>

	<p><i>Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit.</i></p> <p><i>Universiteti Aldent ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të konsultohen me materiale në gjuhë të huaj.</i></p> <p><i>Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën të cilët përgjigjen për mirëmbajtjen dhe nevojave të studentëve. Studentët pajisen me kartë rregjistrimi dhe njihen me rregulloren e funksionimit të bibliotekës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti Aldent disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin FxEducation. Ky sistem është një platformë ku koordinohen të dhënat e sekretarisë mësimore, stafit akademik dhe studentëve me akses të caktuar ndaj informacionit.</p> <p>Sekretaria mësimore dokumentacionin e ruan në dy forma shkresore dhe elektronike. Ajo është përgjegjëse për regjistrat, hedhjen e të dhënave dhe për marrëdhëniet me studentët. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentojë apo provimet që do të jap gjatë vitit akademik.</p> <p>Sekretaria mësimor ka në formë shkresore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrin themeltar të studentëve; • Regjistrin me të dhënat akademike; • Regjistrin e lëshimit të diplomave.

	<p>Regjistrat ruhen pa afat dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Sekretaria mësimore arkivon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dosjet e pranimit dhe regjistrimit të studentëve me gjithë dokumentacionin përkatës; • Procesverbalet e testimeve në provime; • Dosjet e diplomimit; • Dokumentacioni që verifikon plotësimin e kushteve për diploma, procesverbalet e notave të provimit/temave të diplomës; • Listën e të diplomuarve përcjellë rektoratit për miratim, fotokopje të diplomave të tërhequra. <p>Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore, dekani i fakultetit.</p> <p>Evidenca 12.3 FxEducation; Evidenca 12.4 Portali i studentit; RVB.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit.</p> <p>Stafi akademik dhe studentët kanë akses për informacione apo dokumenta të nevojshëm në dobi të programit të studimit. Në sistemin Fx Education, në regjistrat e sekretarisë dhe në zyrat e sekretarisë së titullarit të njëjësive kryesore (fakultetit) pasqyrohen, administrohen dhe ruhen të dhëna dhe informacione, dokumentacione të studentëve që ndjekin studimet dhe të dhëna të rezultateve gjatë viteve të studimit, të dhëna për personelin akademik dhe ndihmës akademik dhe administrativ, programet e studimit kurrikular, të dhëna financiare në lidhje me tarifat e studentëve dhe pagesat e kryera. Aksesit në sistem bëhet në mënyrë të dedikuar në varësi të statusit akademik dhe administrativ.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në këtë sistem kanë profilin e tyre dhe akses të gjithë studentët, i gjithë stafi akademik efektiv dhe me kontratë. Gjithashtu, institucioni u ka vënë në shërbim të gjithë studentëve dhe stafit akademik (PAE dhe PAK) adresat e emailit (emërmbiemër@ual.edu.al), i cili shërben për komunikimin e brendshëm institucional dhe të jashtëm.</p> <p>Evidenca 12.3 FxEducation; Evidenca 12.4 Portali i studentit; RVB.</p>

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët. Sic u theksua me lart çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik. Përveç FxEducation, pedagogët kanë hapësirën e tyre në Platforma Online ku komunikojnë me studentët në lidhje me materialet e leksioneve, moduleve, projekteve mësimore etj. Platforma siguron një komunikim interaktiv ndërmjet studentëve dhe pedagogëve. Evidenca 12.3 FxEducation; Evidenca 12.4 Portali i studentit; RVB.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të të gjitha të dhënave dhe mundësinë e gjenerimit e raporteve në lidhje me frekuentimin, rezultatet, etj. Kjo llogari mundëson pasqyrimin e aktivitetit akademik semestral dhe komunikimin midis stafit për problematikat që lindin nga pasqyrimi i vlerësimit në sistem. Evidenca 12.3 FxEducation; Evidenca 12.4 Portali i studentit; RVB.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi aktivitetet e organizuara nga IAL dhe fakultetet, stafin akademik, programet dhe syllabuset e lëndëve, bazën ligjore që funksionon të IAL, fakultetet, departamentet dhe programet mësimore që zhvillohen në secilin departament, strukturën e vitit akademik, orari mësimor etj. Faqja web e IAL është aktive në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht. Evidenca 20.2 Print screen web UAL.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti Aldent disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin FxEducation. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumenta për studentët dhe pedagogët, çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik. Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore, dekani i fakultetit. Faqja Zyrtare e Universitetit Aldent është: www.ual.edu.al. Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën. Faqja zyrtare në web aktualisht është në gjuhën shqipe dhe angleze.</i></p>




Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Çdo vit akademik Universiteti Aldent harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Shpërndarja bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara në cdo fillim viti akademik.</p> <p>Evidenca 14.2: Të dhëna financiare UAL për pesë vitet e fundit.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani financiar përshkruan kostot e programit duke përfshirë burimet njerëzore, infrastrukurore, materialet e konsumit, përdorimin e pajisjeve laboratorike, zhvillimin e praktikave spitalore, pasurimin e bibliotekës, kostot e auditeve të brendshme dhe të jashtëm. Universiteti Aldent është partner i vetëm dhe vetëfinancon të gjitha shpenzimet.</p> <p>Çdo vit akademik në përfundim hartohen pasqyrat financiare që tregojnë masën e realizimit të Projekt-Buxhetit të përcaktuar. Pasqyrat financiare auditohen në mënyrë të përvitshme.</p> <p>Universiteti Aldent funksionon si një biznes i mirëfilltë dhe i nënshtrohet procedurave ligjore financiare siç janë Bilanci Kontabël, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare dhe Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit.</p> <p>Evidenca 14.2: Të dhëna financiare UAL për pesë vitet e fundit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e</p>	

studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.				
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Universiteti deklaron një gjëndje të qëndrueshme ekonomike me rritje graduale nga viti në vit. Nuk ka detyrime ndaj të tretëve si individë, biznese, banka, tatime apo organizata. Duke pasur një rritje të tillë Institucioni ka investuar në infrastrukturë, logjistikë, laboratorë dhe punësimin e personelit akademik cilësor me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe aktivitetit akademik. Në vlerësimin e GVJ, Institucioni demonstron qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij në përgjithësi dhe ecurinë normale dhe me cilësi të programit MSH në Teknikë Laboratori Mjekësor në veçanti. Evidenca 14.2 Të dhëna financiare të UAL për 5 vitet e fundit			
Konkluzione	<i>Universiteti Aldent harton raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Universiteti Aldent funksionon si një biznes i mirëfilltë dhe i nënshtrohet procedurave ligjore financiare siç janë Bilanci Kontabël, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare dhe Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit. Në vlerësimin e GVJ, Institucioni demonstron qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij në përgjithësi dhe ecurinë normale dhe me cilësi të programit MSH në Teknikë Laboratori Mjekësor në veçanti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni ka hartuar materiale dhe disponon dokumentacion në përputhje me legjislacionin në fuqi ku janë përshkruar politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje.</p> <p>Këto procedura janë në përputhje të plotë me Satutin e Universitetit, rregulloret e FSHMT dhe Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Në këtë dokumentacion përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Procedurat e pranimit realizohen mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara, dhe po ashtu sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit.</p> <p>Në rregulloren e departamentit, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim funksionon dhe sekretaria mësimore. Pranë departamenteve të FSHMT funksionon Zyra e Këshillimit të Studentëve. Informacioni udhërrëfyes për studentët gjendet dhe në faqen ëeb të universitetit.</p> <p>Evidenca 4 Statusi i UA dhe Evidenca 6.1 Rregullorja FSHMT, Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit MSH në “Teknik Laboratori Mjekësor”.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>FSHMT ofron një mjedis të favorshëm përsa i përket respektimit të të drejtave dhe barazive të çdo individi, duke respektuar: shtesën sociale, perkatësinë ndaj një grupi të caktuar, orientimin seksual e identitetin gjinor, bindjen fetare, etninë etj.</p> <p>Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme.</p> <p>Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë.</p> <p>Evidenca 6.1 Rregullorja FSHMT, Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit MSH në “Teknik Laboratori Mjekësor”.</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Para çdo viti akademik pas kërkesës së MAS, Institucioni përcakton kuotat dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike në programet master. Kuotat përcaktohen në bazë të kapaciteteve njerezore, akademike dhe ato logjistike.</p> <p>Në këtë program studimi mund të aplikojnë kandidatët të cilët kanë mbaruar së paku studimet bachelor në teknikë laboratoro mjekësor, brenda apo jashtë vendit.</p> <p>Në këto kriteret përfshihen dhe parashikohet edhe regjistrimi i studentëve të huaj. Në programin e studimit Master i Shkencave në “Teknikë Laboratori Mjekësor” kandidatët vlerësohen dhe klasifikohen në bazë të pikëzimit dhe lista e fituesve bëhet publike. Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve.</p> <p>Evidenca 22.3.1 Model Kontrate studenti.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit, në statut dhe në ëeb janë paraqitur qartë e në mënyrë të kuptueshme informacionet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimin e programeve të studimit; - Kriteret për pranimet në ciklin e parë dhe të dytë; - Ndërprerjen e studimeve, procedurat e transferimit apo të ndjekjes së një programi të dytë studimi; - Rregullat e ekuivalentimit etj. <p>Procedurat e mësipërme si organizimi i programit i ekuivalentimit, transferimit të krediteve u bëhet e ditur edhe koordinatorit të programit. Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset kanë informacion të qartë e të detajuar për format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve, realizimin e praktikës dhe detyrave të kursit, procesin e diplomimit me provim/temë diplome. Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me aksesin në informacion, me funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës, me funksionimin e sekretarisë mësimore në ndihmë të tyre.</p> <p>Evidenca 4 Statusi i UA dhe Evidenca 6.1 Rregullorja FSHMT, Evidenca 6.4 Rregullorja e programit të studimit MSH në “Teknik Laboratori Mjekësor”.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Aldent, përpara fillimit të ri akademik informojnë publikun dhe të interesuarit në lidhje me programet e studimit dhe kriteret përkatëse. Institucioni organizon ditët e hapura informuese dhe është pjesëmarrës i përvitshëm i panairit “Ëork and Study” ku takimet kanë në fokus njohjen e të interesuarve me kriteret e</p>

	<p>përgjithshme dhe specifike për t'u pranuar në programet e studimit, mundësitë e shkollimit dhe punësimit pas mbarimit të programeve të studimit etj. Informacioni gjendet gjithashtu në faqen eeb të universitetit.</p> <p>Evidenca 24.2 Orientimi i maturantëve dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Universiteti Aldent parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, gjithashtu institucioni ka hartuar politika të mbështetjes financiare për të gjitha këto shtresa.</p> <p>Evidenca 14.3 Politikat e mbështetjes financiare të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Pas diskutimit me drejtuesit dhe në bazë të dokumentacionit, Universiteti Aldent dhe Departamenti harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera të cilët janë të interesuar për të ndjekur studimet. Këto kriteret janë përputhje me aktet nënligjore të MAS.</p> <p>Universiteti Aldent çdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmëse për shtresat në nevojë dhe për studentët ekselentë në varësi të arritjeve akademike.</p> <p>Evidenca 14.3: Politikat e mbështetjes financiare të studentëve.</p> <p>Evidenca 7, Tabela 21.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/ bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p><i>Institucioni ka hartuar materiale dhe disponon dokumentacion në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje.</i></p> <p><i>Procedurat e pranimit realizohen mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara dhe po ashtu sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Për programin e studimit Master Shkencor në Teknikë Laboratori Mjekësor GVJ evidenton që institucioni nuk ka përcaktuar kriteret specifike, përveç kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve.</i></p> <p><i>Universiteti Aldent, çdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmës për shtresat në nevojë për studentët ekselentë në varësi të arritjeve akademike dhe për studentët nga shtete të tjera të cilët janë të interesuar për të ndjekur studimet.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Studentët informohen në fillim të vitit akademik për kriteret e kalimit nga njëri vit në tjetrin siç është numri e krediteve që duhet të grumbullojnë. Informacioni është në ëeb dhe gjithashtu jepet nga Sekretariatë Mësimore.</p> <p>Mungesat duhet të shlyhen para vlerësimit përfundimtar të lëndës apo modulit. Në sekretarinë mësimore të FSHMT mbahet regjistri i frekuentimit të procesit mësimor nga studentët e çdo grupi mësimor, i cili plotësohet për çdo orë mësimore.</p> <p>Evidenca 6.1 Rregullore e Universitetit Aldent; Evidenca 6.4 Rregullore e Programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit, studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Informacioni është në ëeb dhe gjithashtu jepet nga Sekretaria Mësimore. Institucioni përmes Dekanit të FSHMT ngre në departament një komision të posaçëm të ekuivalentimit të moduleve dhe programeve i cili vlerëson dhe njih kualifikimet e mëparshme bazuar në dokumentacion i cili përfshin planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve.</p> <p>Evidenca 6.1 Rregullore e Universitetit Aldent; Evidenca 6.4 Rregullore e Programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllabus përcaktohet skema e kontrollit të dijeve e cila ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar. Ky informacion i jepet studentëve në çdo fillim viti nga Departamenti dhe më specifikisht nga pedagogët e lëndëve përkatëse.</p> <p>Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve/provimeve me shkrim/me gojë/projekteve/prezantimeve/praktikave.</p> <p>Në programin e lëndës shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor.</p> <p>Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë:</p>




	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit, vlerësim i cili përbëhet nga dy komponentë: <ul style="list-style-type: none"> – Provim me shkrim (kolokium); – Vlerësimin e vazhduar gjatë semestrit (detyra kursi, projekte, frekuentim, aktivizimi në seminare); • Vlerësimi me provimin përfundimtar. <p>Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët/modulet në planin mesimor përfaqëson 20-40% të vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Në syllabuse përcaktohet në mënyrë të detajuar pragu i pikëve kaluese dhe konvertimi i pikëve në nota.</p> <p>Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe transparencën e vlerësimit. Ata përdorin dhe procedurat e rishikimit të vlerësimit.</p> <p>Evidenca 11 Syllabuset e moduleve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e Institucionit dhe rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë mënyra e diplomimit. Koordinatori i programit informon studentët për procedurat e diplomimit në fillim të ciklit akademik dhe në fillim të vitit të dytë bëhet zgjedhja e temës dhe plotësimi i formularit përkatës. Njësia kryesore ka përgatitur manualin përkatës të përpunimit të diplomës ku përcaktohen karakteristikat dhe struktura e tezës së diplomës. Në rregulloren e programit përcaktohen kushtet që duhet të përmbushë studenti për marrjen e diplomës dhe procedurën e diplomimit. GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit dhe objektivat formuese dhe karakterizuese të tij (diploma dhe suplementi i diplomës).</p> <p>Evidenca 8.1 Modalitetet e diplomës; Evidenca 8.3 Formulari i aplikimit për temën e diplomës.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletëpalosjeve dhe organizimit të ditëve informuese (zakonisht në periudhën mars – maj) për gjimnazistët dhe prindërit e interesuar. Informacioni përditësohet dhe në faqen ëeb të Universitetit Aldent. Institucioni me anë të strukturave si Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe panairit Work and Study ku është pjesëmarrës i rregullt, realizon gjurmimin dhe informimin e kandidatëve për studentë.</p> <p>Evidenca 24.3 Fletëpalosje informuese.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në rregulloren e departamentit, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuset, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit</i></p>




	<p>akademik në tjetrin dhe gjithashtu është përcaktuar shkalla e frekuentimit të detyruar për programin e studimit.</p> <p>Studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme.</p> <p>Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve.</p> <p>Institucioni ka përgatitur dhe një manual instruktues për përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p>Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletëpalosjeve dhe organizimit të ditëve informuese, sekretarisë, stafit akademik kryesisht gjatë panairit <i>Work and Study</i>.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët që ndjekin programin mësimor Master Shkencor në Teknikë Laboratori Mjekësor informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Përmes Sekretarisë Mësimore dhe faqes ëeb ata gjejnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Informacion mbi institucionin që ofron programin e studimit – Informacion për objektivat formuese të programit – Strukturën dhe organizimin e programit – Planin mësimor – Syllabuset – Rregulloren – Suplementin e diplomës <p>Evidenca 20.2 print screen web UAL.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion studenti gjen informacion të detajuar për lëndët e modulet, organizimin dhe shpërndarjen e tyre në semestral, ECTS për</p>

	<p>secilën lëndë e modul, klasifikimin e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë formuese. Në syllabuse studenti orientohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të orës së mësimi (leksion, seminar, praktikë). Informacioni jepet gjithashtu si në fillim të vitit ashtu dhe gjatë tij në varësi të kërkesave të studentëve edhe nga koordinatori i programit dhe pedagogët e lëndëve përkatëse.</p> <p>Evidenca 24.2 Orientimi i maturanteve dhe studentëve “Work and Study”.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka lidhje të ngushta me operatorët mjekësore dhe me Urdhërin e Infermierit, ku marrin informacion për vendet e lira të punës. Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan Zyra e Këshillimit të Karrierës. Institucioni merr informacion dhe nga portali Infermierë për Shqipërinë. Zyra e karrierës mban kontakte të vazhdueshme me student të diplomuar për ndjekjen e karrierës së tyre profesionale dhe për ti njoftuar për mundësi punësimi në aktivitetet e edukimit në vazhdim. Pjesëmarrja e studentëve në aktivitete trajnuese brenda qytetit dhe me gjerë në rajon, gjithashtu shton mundësitë e informimit dhe promovimit të studentëve në tregun e punës.</p> <p>Evidenca 24.1 Rregullore e Zyrës së Karrierës.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidenton që ata informohen hollësisht dhe gjëresisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, aktivitet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse. Në vende të dukshme shpallet orari mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Teknikë Laboratori Mjekësor, në të cilin janë të pasqyruara të gjitha të dhënat në lidhje me procesin mësimor (leksione, seminare, klasat, pedagogët përgjegjës, etj.), këto të dhëna iu dërgohen dhe në formë elektronike studentëve nga koordinatori i programit të studimit. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në spitalet dhe institucionet e tjera të shërbimit shëndetësor. Në funksion të studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë.</p> <p>Takime me studentet dhe me drejtuesit.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë</p>	<p>Në RVB theksohet se Universiteti Aldent ka një sistem informatik të brendshëm Fx Education, përmes të cilit mundësohet informimi studentit për programin e studimit. Studenti disponon një email personal përmes të cilit mund të aksesojë të dhënat e tij në cdo moment. Veç detajeve për programin e studimit dhe detajeve</p>




lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	individuale për notat etj. informacioni i detajuar dhe i rifreskuar ndodhet gjithashtu edhe në faqen ëeb të Institucionit. Faqja web, Takim me Studentet.			
Konkluzione	<i>Studentët që ndjekin programin mësimor informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidenton që ata informohen hollësisht dhe gjërësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Në sekretarinë mësimore të FSHMT janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. Sekretaria ka: <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrin themeltar të studentëve; - Regjistrin e lëshimit të diplomave; - Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave). Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Gjithashtu Institucioni përpunon të dhëna në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studenteve dhe disponon të dhëna të dhëna në lidhje me punësimin pas diplomimit. Vizita në sekretarinë mësimore.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo

<p>diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>tërheqjen e studentëve nga programi i studimit. Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit, të regjistrimit në programet e dyta dhe të çregjistrimit. Këto të dhëna ruhen edhe në systemin Fx Education dhe menaxhohen nga sekretaria mësimore.</p> <p>Evidenca 12.3 Platforma e menaxhimit online FxEducation.</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Për menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, GVJ në takimin me punonjësit e sekretarisë mësimore inspektoi hapësirat e punës dhe arkivimit të dokumentacionit dhe u njoh me një numër dokumentesh si dosja e studentit, dosja e personelit, regjistrat. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit (në hardcopy dhe softcopy përmes Fx Education), në kushte të sigurisë së lartë, në të cilin kanë akses personat e autorizuar në varësi të detyrës (sekretaria, dega mesimore, tutoriati akademik, IT etj). Këto të dhëna menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të infomacionit dhe janë të disponueshme si në sekretarinë mesimore ashtu edhe në sistemin FxEducation. Këto të dhëna janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e autorizuar të të dhënave, infomacioni personal i studentëve ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahet vetëm për palët e autorizuar në plotësim të kriterëve që përcaktohen në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale" si dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore për Arsimin e Lartë si dhe në bazë të Rregulloreve të funksionimit të Universitetit Aldent.</p> <p>Evidenca 12.3 Platforma e menaxhimit online FxEducation, Takimi me drejtuesit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Universiteti Aldent ka përpiluar mekanizma ku ndërmjet dhe drejtorive përkatëse që lidhen me organizimin e punës kryejnë kontrole periodike (auditim të brendshëm) pranë sekretarive mësimore dhe departamenteve ku bëhet vlerësimi i dokumentimit dhe menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të ruajtur dhe sistemuar.</p> <p>Evidenca 21.1 Raporti i NJSBC.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe</p>	<p>Raportet analitike përpilohen nga Institucioni në formën e analizës vjetore. Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për cilësinë në hyrje e</p>

cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	dalje të studentëve. Ka të dhëna në lidhje me kalueshmërinë, frekuentimin, diplomimin. Zyra Alumni gjithashtu harton në menyrë periodike raporte lidhur me punësimin e të diplomuarve. Gjatë takimeve u deklarua që kërkesa të shtuara për punësim ka edhe jashtë Shqipërisë. Evidenca 21.1 Raporti i NJSBC.			
Konkluzione	<i>Në sekretarinë mësimore të FSHMT janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm. IAL përpilon raporte në formën e analizës vjetore të cilët përfshijnë të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimin dhe diplomimin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të UNI ALDENT. Në RVB theksohet se studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UNI ALDENT me senator të zgjedhur nga vetë studentët. Studentet janë pjesëmarrës në: <ul style="list-style-type: none"> • Senatin akademik; • NJSBC; • Komisioni e kurrikulave; • Komisionin e kërkimit shkencor; • Në GVB për akreditimin e programeve të studimit.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve	Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e

<p>të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>zgjedhura, gjithashtu dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët, GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetësorë në mënyrë periodike, përfshihen në punë studimore dhe aktivitete promovionale e trajnuese të organizuara nga FSHMT. Studentët shprehen të kënaqur për përfshirjen e tyre dhe angazhimin për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e procesit akademik.</p> <p>Takim me Studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, institucioni përdor një seri mekanizmesh. Këshilli studentor, i cili funksion në bazë të një rregullore, është organizmi ku studentët debatojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të FSHMT për zgjidhje. Koordinator i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. Koordinator kujdeset për përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit të kurrikulës. GVJ vlerëson se ky është një program i ri dhe ende nuk i është nënshtruar ndryshimeve të kurrikulës.</p> <p>Evidenca 12.5 Rregullore e Këshillit Studentor.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatet e provimeve, me zgjidhjen e tezës pas provimit dhe të ndjekin shkallët e ankimimit për rivlerësim. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Departamenti pas procesit të ankimimit ngrejnë komision rivlerësimi, i cili bën rishqyrtim dhe rivlerësim të provimit.</p> <p>Evidenca 12.2 Rregullore e Sekretarisë.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Studentët janë pjesëmarrës në: Senatin akademik, NJSBC, Komisionin e kurrikulave, Komisionin e kërkimit shkencor, në GVB për akreditimin e programeve të studimit.</i></p> <p><i>Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet edhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies. Në rregulloren e departamentit</i></p>

	<p>dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Koordinatori i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. Koordinatori kujdeset për përfshirjen e studenteve në procesin e rishikimit të kurrikulës. GVJ evidenton që nuk ka ndryshime të kurrikulës pasi ky program është një program i ri.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>FSHMT ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL. Studentet informohen nga faqja e ëeb-it të ual.edu.al e cila përditësohet vazhdimisht.</p> <p>Gjithashtu në funksion të informimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI. - Sekretaria mësimore; është e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim. <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës realizon informimin e studenteve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e tutoriatit. Ky sistem përbëhet nga Këshilli i Tutoriatit i cili funksion si një piramidë deri tek Rektori dhe Administratori i Përgjithshëm. Sistemi mbështet studentët gjatë gjithë periudhës së tyre akademike si në proceset akademike në auditor ashtu edhe gjatë praktikave profesionale.</p> <p>Evidenca 12.6 Rregullore e Tutoriatit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që</p>	<p>Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1 është funksional dhe i përshtatshëm. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte</p>

kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	të procesit mësimor, për pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët. Evidenca 24.1 Rregullore e zyrës së Këshillimit të Karrierës.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	FSHMT u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Pranë institucionit funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës ku studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme. Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për: <ul style="list-style-type: none"> – Identifikimin e lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë; – Identifikimin e burimeve për pozicione të veçanta pune; – Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës; – Identifikimin e aftësive dhe shprehive; – Udhëheqje akademike; – Identifikimin e shprehive dhe aftësive; – Përcaktimin e objektivave të karrierës. Në këtë zyrë studentët gjejnë mbështetje për përgatitje për intervista pune, shkrimin e CV dhe letrave të motivimit etj. Evidenca 24.1 Rregullore e zyrës së Këshillimit të Karrierës.
Kriteri 4. Zyra/ njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në takimin e GVJ me Zyrën e Këshillimit të Karrierës u informuam se kjo drejtori asiston në gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ky program ende nuk ka diplomuar studentët e parë dhe GVJ nuk mund të vlerësojë gjurmimin e tyre. Në rregulloren e funksionimit të Zyrës së Këshillimit të Karrierës theksohet se ajo ka detyrë të mbajë lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një databazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit. Këto të dhëna gjurmimi të studentëve pas përfundimit të studimeve u vihet në dispozicion edhe departamenteve, duke i ndihmuar ata të kenë kontakte të vazhdueshme midis studentëve të diplomuar dhe FSHMT-së. Evidenca 24.1 Rregullore e Zyrës së karrierës.
Konkluzione	<i>FSHMT ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL. Në institucion funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Kjo zyrë mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një databazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Implementimi dhe përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies më qëllim rritjen e cilësisë akademike është një proces i rëndësishëm në përmirësimin e performancës së institucioneve të arsimit të lartë. Gjatë bisedës me drejtues dhe RVB evidentohet që institucioni nxit stafin akademik për implementimin e metodave të reja të mësimdhënies. Evidenca 6.1 Rregullore UA.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron e vlerëson përmes njësive të posaçme periodikisht programet e studimit. Kështu pranë Universitetit Aldent është ngritur dhe funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon në fund të çdo semestri pyetësorët studentëve për matjen e performancës dhe cilësinë e mësimdhënies. Evidenca 4 Statuti; Evidenca 6.1 Rregullore UA; Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Bazuar në statutin e institucionit, studentëve u sanksionohet e drejta për të qenë pjesë aktive e NJSBC, si edhe komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti. Studentët janë pjesë aktive e vlerësimeve periodike të procesit të mësimdhënies. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, dy herë në vit plotësojnë pyetësorët për vlerësimin e metodave të mësimdhënies.

	<p>Studentët janë në fokusin kryesor të Strategjisë së zhvillimit institucional dhe kontribuojnë në mënyrë direkte në vlerësimin si të institucionit në përgjithësi ashtu edhe të programeve apo lëndëve specifike. Përfaqësues të studentëve janë pjesë e grupeve të punës në nivel institucional; përfshirë departamentin, dekanatin dhe rektoratin e institucionit.</p> <p>Evidenca 4 Statuti; Evidenca 6.1 Rregullore UA; Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC; Evidenca 21.3 Pyetësi i studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Siç u theksua dhe më lart pranë Universitetit Aldent funksionon Njësia e Sigurimit të Cilësisë, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësin e studentëve për matjen e performancës.</p> <p>Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, kjo strukturë organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Të dhënat publikohen periodikisht me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë, institucioni përpilon raportin në përmbyllje të çdo viti akademik, i cili publikohet në faqen zyrtare të universitetit. Ky raport realizohet në zbatim të politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Neni 103: “Sigurimi i brendshëm i cilësisë”. Në RVB dhe në takimet me përfaqësues të zyrës u deklarua se për problematikat e shfaqura bëhet adresimi dhe diskutohen hapësirat e përmirësimit.</p> <p>Evidenca 4 Statuti; Evidenca 6.1 Rregullore UA; Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC; Evidenca 21.3 Pyetësi i studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në RVB dhe gjatë takimeve me përfaqësues të institucionit u deklarua se Institucioni, bazuar në strategjinë e tij, informon në mënyrë të rregullt personelin akademik për proceset e vlerësimit të cilësisë duke e nxitur atë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca 4 Statuti; Evidenca 5 Strategjia e institucionit; Evidenca 6.1 Rregullore UA; Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron e vlerëson përmes njësive të posaçme periodikisht programet e studimit. Nga RVB dhe gjatë takimeve me përfaqësues të institucionit u deklarua se Institucioni, bazuar në strategjinë e tij, informon në mënyrë të rregullt personelin akademik për proceset e vlerësimit të cilësisë duke e nxitur atë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar në Nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë: “Institucionet e Arsimit të Lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë”. Struktura dhe funksionimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përcaktohen në Statutin e Institucionit të Arsimit të Lartë. Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e vet përgjegjësitë institucionale për sigurimin e cilësisë. Këto politika përcaktohen në Statutin e IAL, rregulloren e UA, Rregulloren e Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë, dhe janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore. Konkretisht NJSBC e bazon aktivitetin e saj në:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015; – Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018); – Statuti i institucionit; – Vendimet e senatit, urdhërat e brendshëm, plani i punës. <p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. IAL, me vendim të Senatit Akademik ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit. Kjo njësi funksionon në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Vlerësimit të Cilësisë dhe Kurrikulave. Njësia ka rregulloren mbi të cilën bazon aktivitetin e saj dhe vlerëson në mënyrë periodike aktivitetin mësimor dhe kërkimor shkencor të institucionit. Në përbërje të NJSBC janë 4 anëtarë personel akademik, ku përfshihen përfaqësues të fakulteteve dhe një ekspert i jashtëm, gjithashtu në përbërje të NJSBC është dhe një përfaqësues të studentëve.</p> <p>Në detyrat e NJSBC përfshihet vlerësimi i rezultateve të veprimtarive mësimore, kërkimore shkencore duke propozuar dhe ndryshime të nevojshme në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</p>

	<p>Institucioni ka dhe përdor instrumenta për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. UA i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional gjithashtu dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm deklaron se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të Universitetit dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm të cilat diskutohen në të gjitha njësitë e IAL.</p> <p>Mënyra kryesore e vlerësimit realizohet më anë të pyetsorëve të studentëve në lidhje me vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve administrative.</p> <p>NJSBC e bazon veprimtarinë e saj në dokumenta konkrete dhe përpilon një plan kalendarik veprimi. Për të realizuar planin e saj ajo bashkëpunon ngushtësisht me të gjitha strukturat akademike dhe administrative të institucionit dhe ka akses në gjithë dokumentacion akademik dhe administrativ, duke ruajtur anonimatit dhe konfidencialitetin.</p> <p>Kjo njësi periodikisht informon drejtuesit e njësive në lidhje me rezultatet e monitorimeve me qëllim reflektimin dhe përmirësimin e problematikave.</p> <p>NJSBC ka detyrim institucional hartimin e raporteve. NJSBC funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Përcakton pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele. Bashkërendon gjithashtu procesin ndërmjet njësive në nivel institucional; – Monitoron procesin, mbledh informacione, evidenton problematikën, ofron udhëzime dhe rekomandime në jësitë bazë; – Administron dokumentacione, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm. <p>NJSBC mbështet dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë si dhe interpreton detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC; takim me përfaqësues të zyrës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentacionit dhe takimit me përfaqësuesit e NJSBC evidenton që institucioni përdor mekanizma të tillë si pyetësorët e vlerësimit të studentëve, vlerësimit të anëtarëve të stafit</p>




<p>proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>akademik, vetëvlerësimit të pedagogëve. Njësia e sigurimit të brendshëm deklaron se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të UA dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Metodatat të cilat aplikohen janë: pyetësorët për studentët, inspektime gjatë zhvillimit të mësimin, leksione të hapura, intervista, vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës, etj. NJSBC përpiket për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, për të cilat GVJ, inkurajon <i>konsolidimin si procese permanente që kryhen si në nivel institucional dhe gjithashtu në nivel programi studimi duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Evidenca 6.1 Rregullore UA; Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>NJSBC e bazon veprimtarinë e saj në dokumenta konkrete dhe përpilon një plan kalendarik veprimi. Për të realizuar planin e saj ajo bashkëpunon ngushtësisht me të gjitha strukturat akademike dhe administrative të institucionit dhe ka akses në gjithë dokumentacion akademik dhe administrativ, duke ruajtur anonimat dhe konfidencialitetin.</i></p> <p><i>NJSBC përpiket për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, për të cilat GVJ, inkurajon konsolidimin e mëtejshëm si procese permanente që kryhen si në nivel institucional dhe gjithashtu në nivel programi studimi duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi VI.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të</p>	<p>UA përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetësorët</p>

<p>programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti.</p> <p>Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënies së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standardeve akademike.</p> <p>Disa nga instrumentat e vetëvlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analiza vjetore e departamentit; - Vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik; - Pyetësori i studentëve për cilësinë e programit mësimor e mësimdhënien.
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Të gjitha gjetjet e këtyre vlerësimeve janë pjesë e raportit vjetor të NJSBC i cili i vihet në dispozicion rektoratit.</p> <p>Në përmbushjen e këtyre qëllimeve, bazuar në RVB dhe gjatë diskutimeve me drejtuesit, një rol të rëndësishëm kanë departamentet e FSHMT ku koordinatori i programeve realizon funksione specifike në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duke u bazuar gjithmonë në parashikimet ligjore dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së IAL.</p> <p>NJSBC ka realizuar një analizë vjetore të këtij programi studimi të përfshirë në raportin e përgjithshëm të IAL-së, ku ka informacione në lidhje me vlerësimin e studentëve për personelin e angazhuar në program, perceptimin e tyre në lidhje me aspektet e mësimdhënies, aspektet administrative, këshillimit të karrierës, asistencës institucionale etj.</p> <p>Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ identifikoi rezultate të proceseve të anketimit të studentëve. Këto rezultate janë paraqitur në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin vjetor të NJSBC.</p> <p>Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC; Evidenca 21.1.1 Raport NJSBC.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të</p>	<p>Bazuar në dokumentat e Universitetit Aldent dhe nga informacioni i marrë, rezulton se NJSBC bën vlerësim institucional dhe harton raporte për të gjithë programet e studimit. GVJ evidenton se analiza vjetore e programit e përfshirë në raportin e përgjithshëm ka të dhëna</p>

mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.

sasiore dhe bën një analizë të hollësishme por *adresimi dhe zgjidhja e problematikave duhet pasqyruar më mirë.*

Për kryerjen e vlerësimit NJSBC përdor metoda dhe instrumente të ndryshme për mbledhjen e informacionit siç janë: intervistat e strukturuara, intervistat joformale, takimet e drejtpërdrejta me studentë të programit. Gjithashtu institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta siç janë: Monitorimi i mësimdhënies, vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi i kurrikulës, monitorimi i provimeve, dëgjime në auditor, vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve, praktikës etj, **[takimi me stafin, drejtuesit].**

Institucioni, gjithashtu përdor dhe instrumenta të tërthorta vlerësimi siç janë: sondazhe të studentëve, të personelit akademik, ndihmës akademik apo të institucioneve të cilat bashkëpunojnë për programin e studimit, intervista etj. Rezultatet e këtyre vlerësimeve raportohen tek drejtuesit e departamente dhe dekanëve, duke u bërë pjesë e vlerësimit të performancës të çdo pedagogu në fund të vitit akademik.

Një vend të rëndësishëm në këtë vlerësim gjithashtu zë edhe informacioni i përpunuar nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumni, përmes kësaj zyre realizohet “gjurmimi” i studentëve që kanë përfunduar më parë këto programe studimi për evidentimin e pozicioneve të punësimit apo kualifikimet e mëtejshme pas përfundimit të programit të studimit. Takimet me këta studentë japin informacion në lidhje me problemet që mund të përmirësohen me qëllim rritjen e kompetencave profesionale për të përballuar sa më mirë tregun e sfidat e profesionit. Në rastin e këtij programi studimi ende nuk ka studentë alumni pasi ai akreditohet për herë të parë.

Të dhënat e drejtpërdrejta apo të tërthorta që tërheq dhe përpunon NJSBC shërbejnë për të evidentuar treguesit problemikë të cilësisë me qëllim adresimin dhe zgjidhjen e tyre.

Theksojmë që aktorët e jashtëm japin një kontribut mjaft pozitiv në realizimin e praktikave mësimore e profesionale, *nënvizojmë që kontributi i tyre konkret në vlerësimin e realizimit dhe cilësisë së programit të studimit në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij të rritet më tej.*

Evidenca 21.1.1 Raporti NJSBC; Evidenca 24.2, 24.3 Pyetësi i studentëve dhe i stafit.

Konkluzione	<i>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta dhe të drejtpërdrejta vlerësimi. NJSBC ka realizuar një analizë vjetore të këtij programi studimi të përfshirë në raportin e përgjithshëm të IAL-së, ku ka informacione në lidhje me vlerësimin e studentëve për personelin e angazhuar në program, perceptimin e tyre në lidhje me aspektet e mësimdhënies, aspektet administrative, këshillimit të karrierës, asistencës institucionale etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik të Universitetit “Aldent” përshkruhet përbërja e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit në përbërje të këtij komisioni janë 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) janë anëtarë nga personeli akademik i UA, nga një përfaqësues për çdo fakultet, 1 (një) ekspert i jashtëm dhe 1 (një) student. Prania e studentëve si anëtarë të komisionit krijon mundësinë e bashkëveprimit me studentët për të përfituar ndjesinë e tyre dhe për të bërë efektiv kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Evidenca 7, Tabela 24.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e FSHP, Përgjegjësin e Departamentit, Përfaqësues të Stafit Akademik, me Grupin e Vetëvlerësimit me përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës, etj. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, koordinimi dhe angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit të studimit është konceptuar si përgjegjësi dhe angazhim lidhur me:

	<ul style="list-style-type: none"> - Harmonizimin e veprimtarisë të të gjithë strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë e programit të studimit; - Sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për të garantuar dhe përmirësuar cilësinë e programit të studimit; - Hartimin e një programi cilësor që plotëson nevojat e shoqërisë; - Përcaktimin e parimeve, standardeve dhe procedurave të përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces janë të bashkuar dhe koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë. <p>Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetsorëve, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB.</p> <p>Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC; Takime me stafin, studentët, përfaqësues të zyrave.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë. GVJ evidenton që të gjitha proceset dhe aktivitetet në lidhje me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë janë organizuar të centralizuara në nivel institucional, me qëllim përmirësimin dhe thellimin e këtij procesi.</p> <p>Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetsori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studentëve.</p> <p>Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC; Evidenca 21.1.1 Raporti NJSBC.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe</p>	<p>Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit institucioni ka përfshirë ekspertë të jashtëm, proces të cilin GVJ e</p>




<p>sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>vlerëson. Në procesin e vlerësimit instucioni deklaron realizon takime me ish të diplomuar, mjekë specialiste, eksperte të mjekësisë laboratorike të cilët japin mendime të vlefshme në lidhje me përmirësimin e programit të studimit dhe lidhjen më efektive me kërkesat e tregut të punës. Evidenca 24. 1 Rregullore NJSBC.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik të Universitetit "Aldent" përshkruhet përbërja e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit, në përbërje të të cilit janë 5 (pesë) anëtarë, tre anëtarë staf me kohë të plotë në UA, një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i studentëve. GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkuar dhe koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit etj gjenden të publikuara në këtë faqe të hapur për publikun e interesuar. Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët. Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë</p>	<p>NJSBCB realizon pyetësorët institucional në fund të cdo semestri, të cilët publikohen rregullisht dukë rritur transparencën. Në hartimin e raportit NJSBC respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe</p>




<p>dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji 9887/10.03.2008 ndryshuar me ligjin 48/2012). Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individëve. Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen e vet web për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar.</p> <p>Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC; Evidenca 21.1.1 Raport NJSBC; Faqja web; Takime me përfaqësues të zyrës.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, të procesit të akreditimit raportohen pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Në analizën e saj NJSBC-ja informon njësitë bazë dhe ato kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individëve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese dhe analitike, <i>por raporti nuk shoqërohet me plane masash apo adresim problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</i> GVJ vlerëson që gjetjet dhe problematikat e raportimeve të NJSBS adresohen pranë Senatit Akademik të institucionit i cili nxjerr në formën e vendimeve lralin e masave dhe është përgjegjës për plotësimin e tyre.</p> <p><i>GVJ inkurajon që në kuadër të përmirësimit të treguesve të cilësisë, institucioni të zhvillojë më tej mekanizmat analitikë të evidentimit të performancës në nivel institucional dhe adresimit të problematikave në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.</i></p> <p>Nga takimet e realizuara në Institucion GVJ vlerëson se aktorët pjesëmarrës në proceset e vlerësimit si NJSBC, tutoriati akademik, zyra e zhvillimit të karrierës luajnë rol kryesor në ndërgjegjësimin, informimin e personelit akademik, studentëve në lidhje rëndësinë dhe përmirësimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Evidenca 19 Trajnime Stafi UAL; Evidenca 21.1 Rregullore NJSBC.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>NJSBCB realizon pyetësorët institucional në fund të çdo semestri, të cilët publikohen rregullisht duke rritur transparencën.</i></p>




	<p><i>Raporti i monitorimit u komunikohet strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studentëve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individëve.</i></p> <p><i>GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese dhe analitike. GVJ vlerëson që gjetjet dhe problematikat e raportimeve të NJSBC adresohen pranë Senatit Akadëmik të institucionit.</i></p> <p><i>GVJ inkurajon që në kuadër të përmirësimit të treguesve të cilësisë, institucioni të zhvillojë më tej mekanizmat analitikë të evidentimit të performancës në nivel institucional dhe adresimit të problematikave në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson së aktorët pjesëmarrës në proceset e vlerësimit si NJSBC, tutoriati akademik, zyra e zhvillimit të karrierës luajnë rol kryesor në ndërgjegjësimin, informimin e personelit akademik, studentëve në lidhje me rëndësinë dhe përmirësimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në
“Teknikë laboratorit mjekësor”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti
“Aldent”**

Pika të forta dhe afirmime:

1. Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori Mjekësor” është hartuar bazuar në modelet kombëtare dhe Europiane, duke respektuar standardet dhe kornizën ligjore në fuqi.
2. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencës së studentëve dhe pedagogëve me Institucione të Arsimit të Lartë në vende europiane (*Poloni, Ankara, Ceki, Lituani etj.*) të financuar nga Erasmus+.
3. Infrastruktura fizike e UAL, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit si dhe infrastruktura në dispozicion të programit të studimit për realizimin e praktikës mësimore, e cila përbëhet nga 3 laboratorë mjekësorë, një laborator mikrobiologjik dhe dy laboratorë biokimik klinik ku kryhen procedurat laboratorike që i shërbejnë aftësisht profesional të studentëve.
4. Marrëveshjet e bashkëpunimit që ka UAL me institucione shëndetësore publike dhe jo publike për realizimin e praktikës profesionale të studentëve të FSHMT.
5. Mbështetja financiare e stafit akademik në aktivitetin kërkimor shkencor duke ju siguruar infrastrukturën dhe bazën materiale për realizimin e temave të kërkimit shkencor si dhe studentëve për zhvillimin e temave të diplomës apo studime.
6. Biblioteka Universitare ka një fond fizik të bollshëm të literaturës mësimore bazë, literaturës ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore, librari elektronike si dhe hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët.
7. Staf akademik me eksperiencë në mësimdhënie për implementimin e programit të studimit.

Pika të dobëta:

1. Angazhimi në mësimdhënie i personelit akademik me Msc. gjë e cila nuk është në përputhje me nenin 59, pika 6 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Në programet e nivelit të dytë mund të angazhohet vetëm personel akademik i kategorisë lektor dhe profesor. (Standardi IV.1, kriteri 1).

Rekomandime:

1. Të rishikohet shpërndarja e ECTS-ve të lëndëve në kategori duke respektuar peshën e tyre sipas VKM Nr. 41/2018, i ndryshuar.



2. Në programet e nivelit të dytë të angazhohet vetëm personel akademik i kategorisë lektor dhe profesor.
3. Institucioni, inkurajohet që, në kuadër të përmirësimit të treguesve të cilësisë, të zhvillojë më tej mekanizmat analitikë të evidentimit të performancës në nivel institucional dhe adresimit të problematikave në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.
4. Sigurimi i burimeve financiare për kërkimin shkencor duke inkurajuar dhe mbështetur stafin akademik në shkrimin e projekteve dhe aplikimi në organizma Kombëtare dhe Ndërkombëtare.
5. Bashkëpunimi me institucionet shëndetësore publike për implementimin e kontratave të bashkëpunimit të nënshkruar midis tyre dhe UAL.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Science in "Medical Laboratory Technician" provided by the Higher Education Institution "Aldent" University

Strengths and affirmations:

1. Curriculum of the study program of the second cycle Scientific Master in "Medical Laboratory Technician" is designed based on the best national and European models, respecting the standards and legal framework into force.
2. Cooperation and exchange of experience of students and lecturers with institutions of higher education in European countries (*Poland, Ankara, Czech Republic, Lithuania, etc.*) financed by Erasmus+ program.
3. The physical infrastructure of UAL, learning environments, information technology, as well as the available infrastructure to this study program for the realization of teaching practice, which consists of 3 medical laboratories, a microbiological laboratory and two clinical biochemical laboratories where the student performed the laboratory procedures for their professional training.
4. Cooperation agreements of UAL with public and non-public health institutions for the realization of the professional practice of FSHMT students.
5. Financial support of the academic staff in the scientific research activity, providing the infrastructure and laboratory materials for the realization of scientific research as well as students for the development of degree topics.
6. The University Library has an abundant physical fund of basic teaching literature, additional literature, in Albanian and foreign languages, scientific books and magazines, electronic bookstore as well as dedicated spaces for students.

7. Academic staff with experience in teaching for the implementation of the study program.

Weaknesses:

1. Engagement in the educational process of academic staff with Msc. which is not in accordance with article 59, point 6 of the Law on Higher Education 80/2015. Only academic staff of the lecturer and professor category can be engaged in the second level programs. **(Standard IV.1, criterion 1).**

Recomandations:

1. Review of the ECTS distribution of subjects in categories, based on VKM No. 41/2018, as amended.
2. In the second level study programs should be engaged only academic staff of the lecturer and professor category.
3. The institution is encourageg, within the framework of the improvement of quality indicators, to further develop the analytical mechanisms for the identification of performance at the institutional level and the addressing of problems within the framework of continuous improvement.
4. Providing financial resources for scientific research by encouraging and supporting academic staff in writing projects and applying to National and International organizations.
5. Cooperation with public health institutions for the implementation of cooperation contracts signed between them and UAL.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X